

## E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2002

### Në këtë numër:

- Të drejtat e shtetasve dhe procesi i rregullt ligjor.
- Raporti i Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.
- Ligji i ri për Gjykatën Kushtetuese.
- Vendi dhe roli i Gjykatës Kushtetuese në shtetin demokratik

7

Botimi i Qendres Studimore  
Mbi Praktikat Parlamentare  
Dhe Demokratike

# PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri VII, viti 2002

	Faqe
E Drejta Kushtetuese	4
- Shtetasit, të drejtat e tyre dhe procesi i rregullt ligjor Dr. Fehmi ABDIU	7
- Raporti i Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm Kujtim PUTO	13
- Të rejat e ligjit të ri për Gjykatën Kushtetuese, krahasuar me ligjin e mëparshëm Hajredin FUGA	23
- Vendi dhe roli i Gjykatës Kushtetuese në shtetin demokratik. Gjykata Kushtetuese si një mekanizëm i ri në vendet në tranzicion Dr.Xhezair ZAGANJORI	35
- Subjektet kryesore që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Dr.Maksim R.HAXHIA, Av.Artan HAJDARI	42
- Disa refleksione mbi një vendim kundër-obstruksion të Gjykatës Kushtetuese As.Prof. Aurela ANASTASI	53
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend Filip LAKO	63
Përmbledhje e përkthyer në anglisht: Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	72

## TABLE OF CONTENTS:

---

7<sup>th</sup> Issue, year 2002

	Page
Constitutional Law	4
- Citizens, their Rights and the Due Legal Process, Dr. Fehmi AVDIU	7
- The Relations of Constitutional Court with ordinary courts. Kujtim PUTO	13
- The new provisions of the latest law on the Constitutional Court compared to the previous law. Hajredin FUGA	23
- Role and place of the Constitutional Court in the democratic state. The Constitutional Court as a new mechanism in the countries in transition. Dr. Xhezair ZAGANJORI	35
- The main subjects that move the Constitutional Court. Dr. Maksim HAXHIA Av. Artan HAJDËRI	42
- Some comments on a Decision against Obstruction of Constitutional Court. Prof. Ass. Aurela ANASTASI	53
Information on Laws passed by the Assembly Filip LAKO	63
Summary in English: Information on Laws passed by the Assembly	72

---

*Kjo rubrikë synon prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.*

*Në këtë numër të Revistës është përzgjedhur çështja e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, duke patur parasysht rëndësinë që ka ky institucion për respektimin e Kushtetutës dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve. Materialet në vazhdim janë prezantuar në Konferencën mbi Gjykatën Kushtetuese, organizuar disa kohë më parë, nga Instituti i së Drejtës, në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese.*

# Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”

## *Disa probleme procedurale në miratimin e tij*

Nisur nga detyrimi që lind nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 6 të saj ka përcaktuar se «Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.», nga fakti që për përgatitjen e projektligjit nuk ekzistonte ndonjë angazhim serioz nga organet kompetente që kanë të drejtën e nismës legislative, nga e drejta për të kërkuar që edhe Gjykata Kushtetuese të mbështeste organizimin dhe funksionimin e saj në një ligj që duhej të dilte në bazë e për zbatim të Kushtetutës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ndërmorën vetë hapa konkretë për këtë qëllim.

Puna u nis me krijimin e disa grupeve për përgatitjen e projekteve fillestare. Më pas filloi puna për krijimin e një projekti të vetëm, i cili u bë objekt diskutimi e debatesh për shumë seanca e ditë.

Projekti fillestar, i përfunduar në muajin korrik 1999, u dërgua në Komisionin e Venecias, që në datë 15.10.1999 e pati objekt të shqyrtimit të tij në seancë plenare. Më pas, në datën 8.11.1999 projekti është bërë objekt i një diskutimi të hollësishëm në Tiranë, me gjyqtarët e Gjykatës, me juristë të ftuar e specialistë të Këshillit të Europës, të caktuar nga Komisioni “Demokracia nëpërmjet ligjit”.

Në janar të këtij viti projekti u diskutua në një tryezë të rrumbullakët me juristë, me pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, me deputetë e përfaqësues të shoqërisë civile.

Projekti i përpunuar është diskutuar nga një grup prej 35 deputetësh, që ndërmorën nismën për ta dërguar atë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

e më pas në Komisionin e Përhershëm të Ligjeve dhe në grupet parlamentare, ku janë thirrur e dëgjuar specialistë të Kuvendit dhe ekspertë të tjerë.

Disa propozime konkrete të grupeve parlamentare të opozitës, që ishin me interes, shërbyen si shkak për të rimbledhur edhe njëherë Komisionin e Përhershëm të Ligjeve, që u shpreh për pranimin e tyre.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, u vërejt se në projekt ishin reflektuar plotësisht vërejtjet e grupeve parlamentare të opozitës, prandaj projekti në fjalë u miratua me konsensusin e të gjitha grupeve me 105 deputetë të pranishëm.

Për miratimin e tij me një mirëkuptim të tillë, që rrallë ndeshet në veprimtarinë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ndikoi fakti që kishte të bënte me realizimin e një procesi transparent gjatë përgatitjes dhe miratimit të tij. Ai vëren:

1. Puna paraprake për hartimin e projektit të ligjit u bë nga specialistë e ekspertë, profesionistë të vendit e të huaj që njohin natyrën e veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese.

2. U shfrytëzua për këtë qëllim përvoja e legjislacionit të vendeve të ndryshme si e Polonisë, Gjermanisë, Sllovenisë, Italisë, Maqedonisë, Hungarisë etj.

3. U siguria një bashkëpunim i frytshëm me Komisionin “Demokracia nëpërmjet ligjit” për shqyrtimin në parim të projektit e në mënyrë të veçantë për shqyrtimin në detaje e në hollësi të tij.

4. U siguria një bashkëpunim i frytshëm me një numër të madh deputetësh të grupeve të ndryshme, ku merrnin pjesë edhe deputetë të opozitës.

5. U realizua ekspertizë e dobishme nga grupet parlamentare si të pozitës dhe të opozitës.

Gjykata Kushtetuese e ka filluar veprimtarinë e vet mbështetur në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Gjatë këtyre viteve ajo ka përballuar mjaft punë. Ngjarje të rëndësishme

për veprimtarinë e sajë kanë qenë miratimi i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë në fund të nëntorit 1998 dhe miratimi i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i cili sapo ka hyrë në fuqi.

Janë bërë përpjekjet e para për botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të shoqëruara me indeksimin problemor e alfabetik. Po synohet për të krijuar edhe sektorë për informimin e për botimet juridike me karakter teorik. Është siguruar një faqe për informimin në Internet dhe po përgatitet një botim për historikun e saj.

# Shtetasit, të drejtat e tyre dhe procesi i rregullt ligjor

*Dr. Fehmi ABDIU  
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese*

## 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Gjykata Kushtetuese sipas nenit 124 të Kushtetutës “garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj”. Ky konceptim i këtij organi, lidhur me thelbin e funksionit dhe të rolit që ka Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera garanton respektimin e të drejtave themelore kushtetuese të shtetasve, nëpërmjet kontrollit të procesit ligjor.

Për këtë, në pikën f të nenit 131 të Kushtetutës parashikohet se “Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor pasi të kenë shterruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

Përmbajtja e kësaj dispozite ka lidhje me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut që trajton të drejtën për një proces të rregullt. Sipas saj, “Çdo person ka të drejtën që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij.”

Po të krahasojmë përmbajtjen e nenit 6 të Konventës me pikën “f” të nenit 131 të Kushtetutës, vërejmë se procesi i rregullt ligjor në Konventë ka një kuptim shumë më të gjerë se Kushtetuta Shqiptare, sepse Konventa bën fjalë për të drejtën për t’u dëgjuar drejt, në mënyrë publike dhe brenda një afati të arsyeshëm etj. Pra, ky proces nënkupton edhe drejtësinë për thelbin



e çështjes së tij, publicitetin edhe afatin e arsyeshëm etj. Këto të drejta, sipas saj, mund të kenë të bëjnë si me të drejta dhe detyrime me karakter civil, ashtu dhe me çdo akuzë penale të drejtuar kundër tij.

Në lidhje me këtë problem, në legjislacionin e vendeve të ndryshme, vihen re disa prirje.

*Koncepti më i gjerë se ai i procesit të rregullt ligjor në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese*

Kështu, Kushtetuta Kroate, në nenin 125, për këtë problem shprehet se “Gjykata Kushtetuese mbron të drejtat dhe liritë kushtetuese të njeriut dhe qytetarit.”

Në mënyrë të përafërt, Kushtetuta Sllovene, në nenin 160 të saj, ka pranuar se “Gjykata Kushtetuese vendos për ankesat kushtetuese rreth shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet akteve individuale.”

Gjykata Kushtetuese Gjermane, sipas pikës 4 b të Kushtetutës Gjermane, vendos lidhur me rekurset e kushtetutshmërisë që mund të paraqiten nga kushdo që mendon se është cenuar nga administrata publike në njërin prej të drejtave të tij themelore ose në një të drejtë të parashikuar në nenet 20 paragrafi IV, 33, 38, 101, 103 dhe 104.” Pra, në përgjithësi në këto e në të tjera kushtetuta, të drejtat themelore të njeriut mbrohen në gjerësinë e tyre si për sa i përket përmbajtjes, ashtu edhe formës e procedurës.

*Koncept më i ngushtë që lidh mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut nga Gjykata Kushtetuese, me kërkesat e procesit të rregullt ose me ndonjë kërkesë tjetër konkrete*

Kjo prirje është pasqyruar në pikën “f” të nenit 131 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, sipas të cilës “Gjykata Kushtetuese vendos edhe për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

Qëndrimi që mban Kushtetuta jonë ka evoluar edhe në lidhje me atë që ekzistonte në nenin 24 të ligjit “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sipas të cilit “Gjykata Kushtetuese zgjidh përfundimisht ankesat e personave të paraqitur në rrugën e kontrollit për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e pa ligjshme.”

*Koncepti që ka të bëjë me mosangazhimin e Gjykatës Kushtetuese me shqyrtimin e kërkesave individuale, qoftë dhe për të drejtat themelore kushtetuese*

Këtë qëndrim mbajnë disa kushtetuta, si e Hungarisë, Rumanisë, Francës, që nuk parashikojnë një kompetencë të tillë për Gjykatën Kushtetuese.

## 2. DISA KËRKESA TË KUSHTETUTËS PËR PROCESIN E RREGULLT LIGJOR

Duke pasur parasysh përmbajtjen e dispozitës që sapo përmendëm, lidhur me të drejtën e individit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e shohim te nevojshme që në mënyrë të përmbledhur të theksojmë disa çaste që shërbejnë si parakushte për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese:

*2/1 -Kushtetuta bën fjalë për ankesa individuale, që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave themelore kushtetuese, të cilat trajtohen në kreun përkatës të saj.*

Si të tilla nga Gjykata Kushtetuese janë trajtuar e drejta për mbrojtjen, për marrjen dijeni për gjykim, e drejta për apelim, e drejta e pronësisë etj. Në pjesën e dytë të Kushtetutës bëhet fjalë edhe për mjaft të drejta të tjera, prandaj duke qenë kështu, nuk do të ishte normale vendosja e kufizimeve të veçanta, duke i ndarë ato në të drejta kushtetuese më të rëndësishme dhe në më pak të rëndësishme. Këtë qëndrim mendoj se ka pasur parasysh formulimi i pikës “f” të nenit 131 të Kushtetutës me shprehjen “për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese”.

Për rrjedhojë, shtetasit nuk legjitimohen për t’iu drejtuar këtij institucioni dhe për shkeljen e të drejtave të tjera që nuk përfshihen në këtë pjesë të

Kushtetutës, qoftë dhe që lidhen me vendime gjyqësore ose me akte të administratës shtetërore. Për të drejta të tjera, detyra të rëndësishme ka Avokati i Popullit që mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

*2/2- Të drejtat kushtetuese duhet të jenë shkelur nga një proces i parregullt ligjor*

Koncepti i procesit të parregullt ligjor është i gjerë e i papërcaktuar. Ky i fundit mund të jetë gjyqësor ose administrativ. Secili proces duhet konsideruar si i tillë, pra si proces i parregullt, kjo është çështje fakti që shqyrtohet rast pas rasti, po në thelb ai ka të bëjë me garantimin e të drejtave kushtetuese në aspektin procedural. Duke qenë kështu, del e nevojshme për të theksuar se Gjykata Kushtetuese nuk shqyrton zbatimin e ligjit material e as vlerësimin e provave që ka marrë organi që ka shqyrtuar çështjen.

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si raste të tilla janë konsideruar:

a) Dhënia e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje dhe gjykimi i tyre pa pasur dosje.

Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit për një çështje konkrete ka dhënë dy vendime me përmbajtje të ndryshme, me të njëjtin numër e datë, me të njëjtin objekt dhe shkak dhe me pjesëmarrjen e të njëjtave palë.

Gjykata e Kushtetuese i ka konsideruar vendimet për të njëjtën çështje si një proces të parregullt ligjor, që vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 38 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me arsyetimin se “Dhënia e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje nuk është një shkelje formale, por një cenim i rëndë i parimeve kushtetuese të dhënies së drejtësisë dhe garantimit të një

---

1 Shih vendimet nr.1440, datë 19.10.1995 e nr.480 datë 9.4.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

procesi të rregullt ligjor.”<sup>1</sup>

b) Gjykimi në fakt dhe në prova nga Gjykata e Kasacionit i vendimeve të ankimuara është një shkak tjetër për të quajtur si të parregullt procesin gjyqësor.

“Në bazë të nenit 7 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe në bazë të nenit 9 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”; dispozita këto që ishin në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Kasacionit ka shqyrtuar bazueshmërinë në fakt dhe në prova të dy vendimeve të ankimuara. Për këtë arsye është shfuqizuar vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, që për arsyet e lartpërmendura e ka gjykuar çështjen në fakt dhe ka rrëzuar padinë e paditësit. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ky qëndrim, që bie ndesh me nenin 189 të Kodit të Procedurës Civile, e bën procesin ligjor të parregullt.

c) Vendorsja e zgjidhja e çështjes tej objektit të padisë është konsideruar si e tillë se bie ndesh me rregullsinë e procesit, si shkelje me pasoja të rënda që cenon të drejtat themelore të kërkuarit, sepse atij i ka hequr mundësinë që të realizojë të drejtën e mbrojtjes pa pasur dijeni për zgjerimin e objektit të padisë që ka bërë kryesisht Gjykata e Apelit.

Në këtë mënyrë, thuhet në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, “gjykatat kanë shkelur parimin e kontradiktoritetit, që ka për qëllim t’u krijojë si paditësit, ashtu edhe të paditurit mundësinë që në një proces civil të realizojë secili të drejtën e mbrojtjes”<sup>2</sup>.

d) Gjykimi i çështjes pa i komunikuar të gjykuarit rekursi i bërë nga prokurori. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale kanë përcaktuar detyrimin për t’i dorëzuar të gjykuarit kopjen e rekursit të ushtruar nga prokurori. Moskomunikimi nga gjykata i rekursit të gjykuarit e mospatja dijeni për

---

2 Shih vendimin nr.45, datë 27.8.1997 të Gjykatës Kushtetuese

gjykimin e çështjes është konsideruar si shkak për të shfuqizuar vendimet konkrete të gjykatave më arsyetimin së këto përbëjnë procesin ligjor të parregullt.

*2/3- Të jenë përdorur të gjitha mjetet juridike që lejohen për mbrojtjen e të drejtave të tij*

Me pak fjalë, shtetasi që pretendon për të paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të domosdoshme duhet të ketë ezauruar nëpërmjet ankimit ose rekursit të gjitha mjetet që i lejohen në bazë të legjislacionit shqiptar para të gjitha hallkave më të larta të gjyqësorit ose të ekzekutivit.

*2/4-Të respektohet afati i përcaktuar ligjor brenda të cilit lejohet të bëhet ankimi*

Nëse plotësohen kushtet e lartpërmendura, shtetasit që pretendojnë se u janë cenuar të drejtat kushtetuese nga një proces i parregullt ligjor, kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese brenda një afati të caktuar. Sipas nenit 30 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” “afati i paraqitjes së kërkesave është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror.” Ky afat, që është shumë më i gjatë se ai që ekzistonte në bazë të ligjit të shfuqizuar, i krijon mundësi reale individit, për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese. Pra, ky është një afat mjaft i pranueshëm brenda të cilit ai mund të ankohe.

# Raporti i Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm

*Kujtim Puto  
Anëtar i Gjykatës Kushtetuese*

Raporti i Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm mund të trajtohet në shumë drejtime. Por në këtë temë kemi marrë përsipër të trajtojmë problemet që dalin në rastet kur gjykatat e juridiksionit gjyqësor vendosin pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e një ligji ose të një norme të tij.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 145/2 të saj përcakton se: “Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.”

Kushtetuta, të drejtën për të investuar Gjykatën Kushtetuese nuk ia ka dhënë vetëm Gjykatës së Lartë, por çdo instance gjyqësore dhe çdo gjyqtari. Kjo ka anën pozitive, sepse jep mundësinë që të shtrohen për diskutim të gjitha çështjet që ndeshen në veprimtarinë e përditshme të gjykatave (dhe jo vetëm ato që shqyrtohen në Gjykatën e Lartë) dhe për të cilat gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën. Por, nga ana tjetër, dhënia e kësaj kompetente çdo gjyqtari përmban në vetvete mundësinë që në Gjykatën Kushtetuese të vërshojnë një numër i madh çështjesh, disa prej të cilave mund të mos jenë fort të studiuara dhe, për më tepër, mund të bëhen me qëllim për të zvarritur gjykimet. Megjithatë, mund të bëhet kontrolli

i tyre brenda juridiksionit gjyqësor, kur vendimi kundërshtohet sipas nenit 301 e 471/2 të Kodit të Procedurës Civile në gjykatën më të lartë. Kjo e fundit është e detyruar të shprehet për drejtësinë e vendimit të pezullimit jo vetëm në aspektin procedural, por edhe përsa i përket qartësisë apo paqartësisë së normës ose më saktë për kushtetutshmërinë ose jo të normës dhe, në varësi të kësaj, të vendoset për lënien në fuqi ose prishjen e vendimit të gjykatës “inferiore”.

Si neni 145/2 i Kushtetutës dhe Kodet e Procedurave Penale e Civile, nuk përcaktojnë se në cilat raste gjykatat e zakonshme mund t’i hyjnë shqyrtimit e të pezullojnë gjykimin, kur çmojnë se një normë e caktuar është në kundërshtim me Kushtetutën, gjë që nënkupton se ajo mund të bëhet si me kërkesën e palëve, ashtu edhe me nismën e vet. Lidhur me këtë, mund t’i përgjigjemi edhe pyetjes tjetër, për të ditur nëse juridiksioni gjyqësor (gjykatat) e kanë për detyrë të shtrojnë një çështje që duhet gjykuar paraprakisht në Gjykatën Kushtetuese, mjafton që të kërkojnë palët apo pavarësisht nga kërkesat e palëve, është gjykata që e bën këtë vlerësim?

Jemi të bindur se për këtë pyetje të fundit ka vetëm një përgjigje. Pavarësisht nga kërkesat e palëve, janë gjyqtarët ata që çmojnë nëse ligjet vijnë apo jo në kundërshtim me Kushtetutën dhe, vetëm pasi ata binden se janë antikushtetuese, vendosin pezullimin e çështjes dhe dërgimin Gjykatës Kushtetuese. Nëse ata nuk bëjnë një çmim të tillë vazhdojnë gjykimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Pikëpamje të ndryshme ka pasur lidhur me atë nëse gjyqtarët mund të pezullojnë gjykimin e t’ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese në rastet kur çmojnë se një akt nënligjor me karakter normativ vjen në kundërshtim me Kushtetutën.

Sipas një pikëpamjeje, gjyqtarët e sistemit të zakonshëm mund t’i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese të shprehet për kushtetutshmërinë e çdo akti, sepse sipas tyre fjala “ligj”, që përmend neni 145/2 i Kushtetutës, duhet marrë në kuptimin e gjerë, ku përfshihen edhe aktet nënligjore.

Sipas pikëpamjes tjetër, gjyqtarët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm për kushtetutshmërinë e ligjeve, por jo të akteve nënligjore. Neni 145/2 përmend vetëm ligjet, ndërsa kur Kushtetuta do të tregojë edhe për aktet nënligjore, i përmend shprehimisht ato. Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin e saj nr.58, datë 8.10.1999. Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës kishte pezulluar gjykimin e çështjes dhe i kishte kërkuar Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.92, datë 25.2.1999 të Këshillit të Ministrave, duke arsyetuar se vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për nismën e lirë dhe iniciativën private". Gjykata Kushtetuese arsyeton në vendimin e saj se pezullimi i gjykimit nga gjykatat e sistemit gjyqësor vendoset kur çmohet se në kundërshtim me Kushtetutën vijnë vetëm ligjet, por jo edhe aktet me karakter nënligjor. Po në këtë çështje, Gjykata Kushtetuese nuk pranoi të shqyrtonte edhe kërkesën për papajtueshmërinë e vendimit me ligjin, me arsyetimin se kjo kërkesë është jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, mbasi për këtë papajtueshmëri është kompetente gjykata e rrethit gjyqësor dhe jo Gjykata Kushtetuese.

## NDËRHYRËSIT NË PROCEDURËN PARA GJYKATËS KUSHTETUESE

Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në nenin 69 ka përcaktuar se për gjykimin e çështjes, Gjykata Kushtetuese njofton gjykatën dhe thërret subjektet e interesuara. Në këtë përcaktim është respektuar parimi i pavarësisë së juridiksioneve (gjyqësori nga kushtetuesi), sepse ndryshe nga palët e tjera ose subjektet e interesuara, gjykata nuk thirret, por njoftohet. Është lënë në vlerësimin e gjykatës së sistemit gjyqësor të paraqitet ose jo në Gjykatën Kushtetuese, për të dhënë mendimet. Por nga ana tjetër ndiqet rregulli që shqyrtimi i çështjes bëhet pa ndërhyrjen e palëve. Lidhur me këtë të fundit ka argumente pro dhe kundër. Në favor të mosthirrjes së palëve është argumenti se në këtë mënyrë gjykimi i çështjes



bëhet më i shpejtë dhe pretendimet e palëve ndodhen në dosjen e gjykatës së juridiksionit gjyqësor që vë në lëvizje procesin kushtetues. Në favor të thirrjes së palëve, është argumenti që dëgjimi i drejtpërdrejtë i tyre ose paraqitja e pretendimeve drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, megjithëse mund të vonojë përfundimin e procesit, jep ndihmesë kryesore, sepse ndriçon gjykatën për aspektet e ndryshme juridike të çështjes. Sipas tyre, ky qëndrim është më afër garancive të nenit 6.1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (E drejta për një proces të rregullt), aq më tepër që procedura para Gjykatës Kushtetuese mund të jetë përfundimtare për përcaktimin e të drejtave civile ose për akuzën në çështjen penale që do të zgjidhë gjykata dërguese. Është e dëshirueshme që, në zbatim të atij neni të Konventës, palët në mosmarrëveshje të mundin të bëjnë të vlefshme pikëpamjen e tyre para Gjykatës Kushtetuese, sipas mënyrave të përcaktuara në ligjin organik të kësaj Gjykate.

Mendojmë se mënyra e shqyrtimit të çështjeve para Gjykatës Kushtetuese është në përshtatje me frymën e përmbajtjen e Konventës Europiane, sepse gjykimi i çështjes bëhet duke u bazuar jo vetëm te vendimi i gjykatës dërguese, por te gjithë dosja e asaj Gjykate. Palët kanë të drejtë që mendimet e tyre për kushtetutshmërinë ose jo të normës t'i depozitojnë në dosjen e gjykatës dërguese dhe këto i përcillen Gjykatës Kushtetuese. Jo vetëm kaq, por siç përmendëm më lart, në gjykim thirren edhe subjektet e interesuara, zakonisht autorët e normës legislative të kontrolluar: organet që e kanë propozuar dhe e zbatojnë, ata që e kanë miratuar etj. Nuk përjashtohet që me kërkesën e tyre Gjykata Kushtetuese të miratojë ndërhyrjen në gjykim të personave publikë ose privatë, që justifikojnë interesin në mosmarrëveshje. Këto mund të jenë organe dhe shoqata pa qëllime fitimi, objekti social i të cilave është në raport të ngushtë me normën e kontrolluar. Por nuk është e justifikuar që palët në mosmarrëveshje të njëjtë me atë në gjykim të paraqesin vërejtjet e tyre në Gjykatën Kushtetuese, sepse ato mund të shkaktojnë vështirësi të mëdha në trajtimin e çështjes për shkak të numrit të tyre të madh etj.

## INTERPRETIMI I NORMËS NË ÇËSHTJEN PARAGJYQËSORE

Kur Gjykata Kushtetuese pyetet nga juridiksioni gjyqësor për kushtetutshmërinë e një norme, shtrohet pyetja se cila është rëndësia e këtij interpretimi në raport me interpretimet që bëjnë gjykatat.

Dihet se ashtu si të gjitha organet shtetërore, edhe gjykatat bëjnë interpretimin e Kushtetutës e të ligjit, sepse edhe Kushtetuta është ligj. Por dallimi thelbësor midis interpretimit që bëjnë gjykatat e sistemit gjyqësor nga interpretimi i Gjykatës Kushtetuese është se kjo e fundit bën interpretimin përfundimtar, pra ka monopolin e interpretimit autentik të Kushtetutës. Kjo zgjidhje, për mendimin tonë justifikohet me atë që Gjykata Kushtetuese në hierarkinë e organeve shtetërore është vendosur në një nivel me atë të ligjvënësit. Në fakt, ajo ngjan si një ligjvënës “negativ”, sepse sipas nenit 132/1 të Kushtetutës ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton.

Megjithatë, kompetenca e gjykatave të sistemit gjyqësor, për të bërë interpretimin e ligjeve dhe madje të Kushtetutës si ligj (themelor), është e pamundur të mos sjellë edhe mosmarrëveshje të ndryshme.

Së pari, ia vlen të theksohet se Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet jo vetëm për kushtetutshmërinë ose jo të normës për të cilën pyetet, por edhe për kushtetutshmërinë e interpretimit të bërë nga gjykatat në rastet kur ato kanë bërë interpretim. Në këtë mënyrë, mendojmë se kompetencat përkatëse të të dy gjykatave zhvillohen normalisht pa përplasje.

Së dyti, kur Gjykata e Lartë ka bërë interpretim të normës dhe ky interpretim sipas Gjykatës Kushtetuese është në kundërshtim me Kushtetutën, kjo e fundit duhet të shfuqizojë vendimin e gjykatës. Ajo nuk mund të lëjë pa i dhënë rrugë kuptimeve e qëndrimeve të ndryshme për Kushtetutën ndërmjet organeve legjislativë, ekzekutive e gjyqësore. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese luan rol paqtues.

Së treti, gjykatat e sistemit gjyqësor duhet të cedojnë (lëshojnë pe) përballë vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sepse nuk mundet të imagjinohet që ato të mbahen te një interpretim jokushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Së katërti, në praktikë mund të paraqiten edhe raste kur gjykatat inferiore kanë bërë interpretime të ndryshme nga interpretimi që ka bërë Gjykata e Lartë. Në të gjitha këto raste Gjykata Kushtetuese do të shprehet për kushtetutshmërinë e normës së vënë në diskutim, por nuk mund të prekë kompetencat dhe rolin thelbësor të Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e çështjeve dhe njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore. Është kjo gjykatë që vendos në fund të fundit interpretimin adekuat të normës në rastin konkret të jetës, mjafton që ky interpretim të mos vijë në kundërshtim me Kushtetutën. Është po kjo gjykatë, që vendos sipas normave procedurale, nëse do ta zgjidhë çështjen vetë apo t'ia kalojë gjykatave inferiore.

Së pesti, shtrohet problemi nëse Gjykata Kushtetuese kur shqyrton çështjen, a ka të drejtë të ndërhyjë në vlerësimin e vendimit të gjykatës së zakonshme, pra të japë mendim për veprimtarinë e nivelin profesional të vendimit të gjykatës për nevojën e marrjes së tij apo vetëm t'i japë përgjigje pyetjes nëse është apo jo kushtetuese norma juridike.

Në vendimin nr.15, datë 7.4.2000, dhënë mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se: kolegjet e bashkuara kanë vendosur gabimisht pezullimin e çështjes me idenë se neni 473 i Kodit të Procedurës Civile është i papajtueshëm me Kushtetutën për arsye se kjo dispozitë procedurale nuk është e zbatueshme gjatë procedurës së gjykimit në kolegjet e bashkuara, po në kolegjet seleksionuese, pra në një fazë të kaluar (kapërcyes). Po në këtë vendim arsyetohet se në rastin konkret nuk rezulton që të ketë lidhje të drejtpërdrejtë midis antikushtetutshmërisë së dispozitës konkrete të atakuar, me mënyrën e zgjidhjes së çështjes me objekt pavlefshmëri e dëshmisë së trashëgimisë nga ana e Kolegjeve të Bashkuara.

Për të dhënë pikëpamjet tona për këto qëndrime ia vlen të theksojmë se në një sistem organizimi shtetëror, ku Gjykata Kushtetuese ndodhet “jashtë” organizimit gjyqësor, është më e përshtatshme të ruhet pavarësia e ndërsjellë e dy sistemeve juridike: sistemit kushtetues dhe sistemit të zakonshëm.

Prandaj, i takon gjyqtarëve të sistemit të zakonshëm të vendosin nëse norma është e tillë, që për kushtetutshmërinë e tyre duhet pyetur Gjykata Kushtetuese. T'i lejosh Gjykatës Kushtetuese të vendosë për drejtësinë e vendimit pezullues të gjykatave të zakonshme dhe me këtë arsytim të mos pranosh shqyrtimin e çështjes, do të thotë të lejosh ndërhyrjen në një sistem tjetër juridik. Gjykata Kushtetuese i përgjigjet pyetjes nëse është apo jo antikushtetues një normë dhe as nuk mund të përzihet në drejtësinë e vendimit të pezullimit dhe as në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete nga gjykatat e sistemit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese nuk na duket se del tej kompetencave të veta, por interpreton nenin 145/2 të Kushtetutës, kur arrin në përfundimin se gjykatat e sistemit gjyqësor mund të pezullojnë gjykimin e t'ia dërgojnë çështen Gjykatës Kushtetuese, kur problemi i konstitucionalitetit të ligjit atyre gjykatave u del gjatë shqyrtimit të një çështje, por jo pas përfundimit të saj. Në këtë kontekst edhe pezullimi i çështjes në Kolegjet e Bashkuara për kushtetutshmërinë e një norme, që ka të bëjë me kolegjin seleksionues, një fazë e kaluar tashmë dhe dërgimi për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, mund të mos e verë në lëvizje këtë të fundit.

## PËRDORIMI I VENDIMIT TE GJYKATËS KUSHTETUESE NGA GJYQTARI DËRGUES

Ja vlen të trajtohet se në çfarë mënyre dhe në ç' masë gjyqtari dërgues duhet të zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së vet.

Është e qartë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e Kushtetutës është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim, si kur shfuqizohet norma, ashtu edhe kur nuk pranohet kërkesa me arsyetimin se ajo nuk është antikushtetuese.

Në rastin kur nuk pranohet kërkesa dhe nuk shfuqizohet norma ekzistuese,

qëndrimi i gjyqtarit është më i qartë. Ai detyrohet ta zbatojë këtë normë në elementet e mosmarrëveshjes që duhet të vendosë. Në rastin kur kërkesa pranohet dhe Gjykata Kushtetuese vendos shfuqizimin e normës si antikushtetuese, problemi paraqet disa vështirësi për gjyqtarin dërgues. Së pari, ai duhet t'i përmbahet vetëm pjesës urdhëruese të vendimit apo edhe pjesës arsyetuese? Së dyti, gjyqtari dërgues në vendimin e vet përfundimtar do t'i përmbahet vetëm interpretimit të Kushtetutës nga Gjykata Kushtetuese apo edhe interpretimit të ligjit?

Mendojmë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet konceptuar si një i tërë. Pjesa urdhëruese është konkluzioni logjik i asaj arsyetuese dhe nuk mund të merret e shkëputur. Natyrisht që pjesa arsyetuese shpesh bën jo vetëm interpretimin e Kushtetutës, po edhe të normave ligjore. Por, edhe këto mendoj se nuk mund të merren të shkëputura, sepse interpretimi i ligjit bëhet në këndvështrimin kushtetues dhe nuk mund të mendohet që gjyqtari të mos i përmbahet interpretimit kushtetues në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Me vendimin nr.59, datë 5.11.1999 Gjykata Kushtetuese shfuqizoi si antikushtetues paragrafin e tretë të nenit 48 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", që përcaktonte se gjyqtarët që nuk e kalojnë provimin shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka bërë jo vetëm interpretimin e Kushtetutës, nenit 147/6, që lejon shkarkimin për pamjaftueshmëri profesionale, por edhe të nenit 45 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i cili e trajton në mënyrë të detajuar vlerësimin e aftësisë profesionale (me disa tregues). Ajo shkoi edhe më tej, duke arsytuar se meqë pjesëmarrja në provim është një detyrim ligjor, secili gjyqtar mban përgjegjësi nëse nuk e përmbush këtë detyrim, pra, gërshetoi interpretimin e Kushtetutës për shtetin e së drejtës me detyrimin për zbatimin e ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Sipas nenit 124 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese bën interpretimin

përfundimtar të Kushtetutës. Si rrjedhojë, gjykatat, ashtu si çdo organ tjetër shtetëror, duhet të pranojnë interpretimin e normave, të frymës ose të përmbajtjes së Kushtetutës të bërë prej saj. Duke u shprehur për përmbajtjen e një norme, Gjykata Kushtetuese ka në kompetencë të shprehet jo për gjithë elementet ose për rrjedhojat që mund të sjellë zbatimi i saj, por vetëm nëse ajo është e pajtueshme ose jo me Kushtetutën, siç përcaktohet në nenin 131/a të kësaj Kushtetute. Në këta kufij interpretimi i Kushtetutës, dhe lidhur me këtë edhe i ligjit, është i detyrueshëm për gjykatat. Ia vlen të diskutohet për rastet kur Gjykata Kushtetuese në interpretimin e ligjit ka dalë haptazi në pjesën arsyetuese, në çaste të caktuara, tej kompetencave të saj p.sh., kur ka vlerësuar oportunitetin e një ligji ose norme. Në këto raste dhe për aq sa ajo ka tejkaluar kompetencat, ka mendime që kjo pjesë e vendimit mund të mos jetë e detyrueshme për gjykatat e sistemit gjyqësor.

Në rastet kur Gjykata Kushtetuese vëren papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, ajo, sipas nenit 132/1, vendos vetëm shfuqizimin e aktit që shqyrton, pra nuk bën normë të re dhe as i ndryshon ato. Por periudha nga pezullimi i çështjes, deri në hyrjen në fuqi të ligjit ose normës së re, është relativisht e gjatë. Ajo përmban shqyrtimin e çështjes në Gjykatës Kushtetuese e botimin e vendimit të saj në Fletoren Zyrtare, përgatitja e shqyrtimi i projektinormës së re nga ligjvënësi, si dhe koha e nevojshme për hyrjen në fuqi të tij. A mundet që gjyqtari dërgues të gjejë një zgjidhje për çështjen, që nga një anë të mos vonojë shqyrtimin e çështjes së pezulluar dhe nga ana tjetër të mos japë vendim të gabuar? Është vështirë të imagjinojmë që gjyqtari dërgues të përpunojë një rregullim juridik që zëvendëson normën e kontestuar duke u bazuar në motivimin e vendimit nga Gjykata Kushtetuese. Kjo sepse ligjvënësi nuk e ndalon asnjë që, duke u bazuar në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, të shkojë edhe më tej nga ç' ishte më parë në detajimin e normës. Prandaj mendojmë se gjyqtari nuk ka rrugë tjetër veç të presë botimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese edhe, në rastet kur kjo e fundit ka shfuqizuar ligjin si antikushtetues, duhet të presë ndërhyrjen e legjislatorit

e botimin e normës së ndryshuar në Fletoren Zyrtare.

Nga ana tjetër, sipas nenit 76 të ligjit “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (nr.8577, datë 10.2.2000) vendimi i kësaj të fundit që ka shfuqizuar një ligj (ose akt normativ) si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull, sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi. Por ky rregullim nuk sjell asnjë pasojë për çështjet e pezulluara, sepse pika e dytë e nenit të lartpërmendur ka bërë përjashtim, duke i dhënë fuqi prapavepruese vendimit të Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar ligjin përsa i përket çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë.

# Të rejat e ligjit të ri për Gjykatën Kushtetuese, krahasuar me ligjin e mëparshëm

*Hajredin Fuga  
Anëtar i Gjykatës Kushtetuese*

Pas shfuqizimit të Kushtetutës së vitit 1976, Shqipëria operoi për një kohë relativisht të gjatë me një paketë ligjesh kushtetuese, me qëllim që nëpërmjet këtij legjislacioni të përkohshëm, t'u jepej fund praktikave të regjimeve komuniste në qeverisje dhe në ekonomi, si dhe për të themeluar e përkrahur ndryshimet e reformat e reja. Duke e parë në këtë aspekt, mendoj se këtu qëndron rëndësia e vlera e paketës kushtetuese në tërësi, përfshirë edhe ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 për “Organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese”, që u bë pjesë e Dispozitave Kryesore Kushtetuese të miratuara më 29.4.1991.

Ligji nr.7561, datë 29.4.1992, në vështrim juridik është akti që shënon krijimin e Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri.

Ligji kushtetues nr.7561, përmban gjithsej 11 nene për Gjykatën Kushtetuese. Nga neni 17 deri në nenin 21 përcaktoheshin funksioni i Gjykatës Kushtetuese dhe pavarësia e këtij organi, përbërja e Gjykatës Kushtetuese dhe mënyra e përtëritjes, afati i qëndrimit në detyrë dhe cilësitë që duhej të përmbushte gjyqtari kushtetues, papajtueshmëria e funksionit me qënien në detyra të tjera, si dhe moslejimi i kryerjes së veprimtarive publike e private. Në nenet 22 deri në 27, rregulloheshin çështjet që kanë të bëjnë me paprekshmërinë penale të gjyqtarit kushtetues, rastet e mbarimit



të mandatit, kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe të drejtën e saj për të vendosur ndreqjen e pasojave dhe kompensimin e dëmit, subjektet që e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe mënyrën e marrjes së vendimeve dhe karakterin përfundimtar e të formës së prerë. Mund të themi se ligji kushtetues për Gjykatën Kushtetuese edhe pse nuk mund të ishte i përsosur, krijoi bazën e duhur juridike, që i shërbeu këtij organi të përmbushë funksionin e tij.

Është normale që kur një ligj zëvendësohet, ligji i ri që e zëvendëson, patjetër do sjellë të reja, do të sjellë ndryshime dhe përmirësime, por në rastin konkret ndryshimet midis dy ligjeve janë të kushtëzuara nga dy faktorë:

Faktori i parë ka të bëjë me ndryshimin e bazës kushtetuese mbi të cilën janë mbështetur të dy ligjet. Ligji i mëparshëm i datës 15.7.1998 është bazuar në Dispozitat Kryesore Kushtetuese, kurse ligji i ri i datës 10.2.2000, mbështetet në Kushtetutë. Midis Dispozitave Kryesore Kushtetuese dhe Kushtetutës, përsa i përket Gjykatës Kushtetuese, ka dallime të rëndësishme, të cilat patjetër që do reflektoheshin në ligjin e ri organik “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe që e dallojnë këtë nga ligji i mëparshëm.

Cilat janë disa nga dallimet më kryesore midis dy ligjeve kushtetues, pra midis Dispozitave Kryesore Kushtetuese dhe Kushtetutës? Ka ndryshuar kompetenca e Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa sipas Dispozitave Kryesore Kushtetuese, në rrethin e çështjeve që shqyrtonte Gjykata Kushtetuese ishte edhe papajtueshmëria midis ligjeve ose papajtueshmëria midis akteve nënligjore dhe ligjit; sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk ka më kompetencë të vendosë për këto papajtueshmëri, por vetëm për papajtueshmërinë e ligjeve dhe akteve normative me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas Dispozitave Kryesore Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese shqyrtonte akuzën penale kundër Presidentit, kurse sipas Kushtetutës, këtë kompetencë nuk e ka më. Ndryshe nga Dispozitat

Kryesore Kushtetuese, sipas të cilave gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidheshin nga Kuvendi ose emëroheshin nga Presidenti i Republikës në raportin 5 me 4, sipas Kushtetutës, gjyqtari kushtetues emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqim të Kuvendit. Ndërsa sipas Dispozitave Kryesore Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zgjidhej nga Mbledhja e Gjyqtarëve për një afat 3-vjeçar sipas Kushtetutës, Kryetari emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqim të Kuvendit për një periudhë prej 3 vjetësh. Kërkesa dhe kritere të ndryshme duhet të plotësonte gjyqtari kushtetues sipas Dispozitave Kryesore Kushtetuese, pra të kishte jo më pak se 10 vjet veprimtari juridike ose si pedagog, ndërsa Kushtetuta kërkon një stazh profesional për emërimin gjyqtar, jo më pak se 15 vjet. Dispozitat Kryesore Kushtetuese nuk parashikonin shkarkimin e gjyqtarit kushtetues, ndërsa Kushtetuta ka përcaktuar shkaqet dhe procedurën që ndiqet për shkarkimin e gjyqtarit. Në krahasim me Dispozitat Kryesore Kushtetuese, Kushtetuta ka zgjeruar rrethin e subjekteve që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si p.sh. Avokati i Popullit, organet e bashkësive fetare, partitë politike dhe organizata të tjera, natyrisht për çështje që lidhen me interesat e tyre, si dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Dispozitat Kryesore Kushtetuese i njihnin Gjykatës Kushtetuese të drejtën të vihej në lëvizje me nismën e saj, kurse Kushtetuta nuk e parashikon këtë të drejtë, ashtu sikurse nuk parashikon të drejtën për ndreqjen e pasojave dhe kompensimin e dëmit.

Dallimet në bazën kushtetuese janë faktori kryesor që ka determinuar edhe në ndryshimet midis ligjit të mëparshëm dhe ligjit të ri për “Organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Faktori i dytë ka të bëjë me procesin e hartimit të projektligjit të ri. Gjatë hartimit të këtij projekti, u përfshinë gjithë gjyqtarët e Gjykatës, u organizuan këshillime e diskutime me juristë të sferës konstitucionale, me përfaqësues të organizatave joqeveritare, u sigurua konsulencë e kualifikuar me ekspertë të Komisionit të Venecias, si dhe u studiuuan dhe u

shqyrtuan ligje organike të gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera. Ky proces i gjerë dhe i hapur ndikoi shumë në ngritjen cilësore të ligjit dhe në zgjidhjen e disa problemeve delikate, sikurse mund të përmend procedurat e veçanta, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese kur shfuqizohet ligji ose akti normativ, përcaktimi i disa rregullave të posaçme që e dallojnë gjykimin kushtetues nga gjykimi i zakonshëm etj.

Pikërisht këta dy faktorë kushtëzuan ndryshimet midis dy ligjeve organike: Ligji i mëparshëm kishte gjithsej 48 nene, kurse ligji i ri ka 88 nene, nga të cilat 39 nene janë dispozita krejt të reja, rreth 40 nene paraqesin ndryshime në formulim e në përmbajtje dhe vetëm 7-8 nene janë identike me ligjin e mëparshëm.

Për të paraqitur dallimet e veçanërisht të reja që sjell ligji i ri, problemi duhet parë në dy aspekte: në aspektin e strukturës së ligjit të ri dhe kryesorja në aspektin e përmbajtjes.

Në aspektin strukturor, ligji i ri është i ndarë në 9 krerë. Nga pikëpamja e ndarjes në kre, në ligjin e ri janë nxjerrë më vete kreu mbi statusin e gjyqtarit kushtetues, kreu mbi parimet e gjykimin kushtetues dhe kreu mbi procedurat e veçanta, ndërsa në ligjin e mëparshëm këta kre nuk ekzistonin. Në aspektin e vendosjes së dispozitave, gjithashtu ligji i ri ka bërë një ndërtim më shkencor e sipas një rendi kronologjik.

Ndryshimet më të rëndësishme midis dy ligjeve dhe të reja të ligjit të ri, janë padyshim në përmbajtjen e tyre.

Ligji i ri sanksionon në mënyrë më të qartë elementet e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese. Nenet 2 dhe 4 të ligjit të mëparshëm nuk i theksojnë aq dukshëm këto elemente. Në nenin 2, p.sh., thuhet që Gjykata Kushtetuese është e pavarur nga çdo organ tjetër në ushtrimin e funksioneve, në organizimin e saj dhe në marrëdhëniet financiare, kurse në nenin 4 thuhet që Gjykata Kushtetuese harton buxhetin e saj që miratohet nga Kuvendi. Në ligjin e ri këto elemente janë pasqyruar ndryshe. Kështu, në nenin 3 të ligjit të ri thuhet që Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të

plotë organizative, administrative e financiare, ndërsa në nenin 6 thuhet se Gjykata Kushtetuese administron buxhetin, i cili hartohet prej saj dhe miratohet nga Kuvendi. Pra, siç kuptohet, nuk kemi të bëjmë thjesht me zëvendësim termash, por me nxjerrjen në dukje në mënyrë sa më të qartë të atyre elementeve që janë thelbësore për realizimin e një pavarësie reale.

Pjesa e organizimit të Gjykatës Kushtetuese ka ngjashmëri në të dy ligjet, por megjithatë edhe në këtë drejtim ka dallime që janë rrjedhojë e dallimeve midis Dispozitave Kryesore Kushtetuese në krahasim me Kushtetutën, si p.sh., për mënyrën e ndryshme të caktimit të gjyqtarëve, të kryetarit, të mbarimit të mandatit të gjyqtarit etj. Megjithëkëtë, në lidhje me mbarimin e mandatit të gjyqtarit është me interes të theksojmë se ligji i ri ka ndryshime përsa i përket shkaqeve dhe procedurës së deklarimit të mbarimit të mandatit. Kështu, janë vendosur si shkak për mbarim të mandatit dënimi me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, mbushja e moshës 70 vjeç, deklarimi i paafte për të vepruar me vendim gjyqësor. Po kështu, ndërsa sipas ligjit të mëparshëm deklarimin e mbarimit të mandatit e bënte Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas ligjit të ri, deklarimi i mbarimit të mandatit bëhet me vendim të Gjykatës Kushtetuese, gjë që përbën një element sigurie më të madhe për gjyqtarët kushtetues.

Ndër të rejat që sjell ligji i ri është edhe përcaktimi i shkaqeve për shkarkimin e gjyqtarit kushtetues dhe procedura që ndiqet në këtë rast. Sipas nenit 10 të ligjit të ri, bazuar edhe në Kushtetutë, gjyqtari mund të shkarkohet për shkelje të Kushtetutës për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore e fizike, si dhe për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij. Shkarkimi vendoset me 2/3 e gjithë deputetëve të Kuvendit, mbi kërkesën e motivuar të jo më pak se 1/2 e gjithë deputetëve, por ky vendim i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila deklaron shkarkimin ose shfuqizon vendimin e Kuvendit kur këtë e gjen të pabazuar.

Sipas ligjit të mëparshëm, nenit 14 të tij, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese kishte të gjitha kompetencat me karakter organizativ, administrativ dhe

financiar. Ligji i ri ka bërë një rregullim të ndryshëm, duke kufizuar në mënyrë të ndjeshme kompetencat e Kryetarit dhe kalimin e tyre mbledhjes së gjyqtarëve. Sipas nenit 13 të ligjit, mbledhja e gjyqtarëve përcakton drejtimit kryesore të shpenzimit të mjeteve buxhetore dhe informohet çdo 6 muaj për shpenzimet e bëra, vendos për strukturën organizative të Gjykatës Kushtetuese, vendos për numurin e personelit dhe pagat e tyre, miraton rregulloren e brendshme për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese, emëron Sekretarin e Përgjithshëm. Dhënia e kompetencave të tilla mbledhjes së gjyqtarëve meriton vlerësim, sepse në pozita kontrolli e vendimmarrje të gjithë gjyqtarët për problemet më kryesore organizative e financiare të Gjykatës, rrit përgjegjësinë e tyre për to, krijon qëndrueshmëri në veprimtarinë e Gjykatës dhe mënjanon marrjen e vendimeve individuale për këto çështje të rëndësishme të këtij organi.

Sikundër theksuam, në kreun III të ligjit të ri janë vendosur dispozitat për statusin e gjyqtarit. Ligji i mëparshëm kishte vetëm një nen që rregullonte problemin e pagës, kurse ligji i ri përmban katër dispozita ku përfshihen rregullat për imunitetin e gjyqtarit kushtetues, për paprekshmërinë e tij gjatë ushtrimit të veprimtarinë dhe për mospërgjegjësinë ligjore për mendimet ose votën e shprehur për çështjet në shqyrtim, si dhe mosndjekjen penalisht pa pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese. Edhe në rastet e kimit në flagrancë, ndalimi ose arrestimi i gjyqtarit kushtetues, nuk mund të vazhdojë më tej, kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin e tij në gjykatë.

Në kreun mbi statusin janë përmendur të drejtat e tjera të gjyqtarit kushtetues si p.sh., të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës kur një gjë e tillë kërkohet ose çmohet e domosdoshme, kanë të drejtë të pajisen falas me Fletoret Zyrtare, revistat e botimet juridike, përfitojnë një leje të pagueshme vjetore prej 40 ditë, përfitojnë po ato të drejta që gëzon deputeti i Kuvendit, kanë të drejtë që pas mbarimit të

mandatit të caktohen në një detyrë të barabartë ose të përafërt, të përfitojnë nga pagesa kalimtare dhe pension suplementar dhe së fundi, gëzojnë status protokollar të barabartë me atë të ministrit, ndërsa Kryetari vjen menjëherë pas Kryeministrit. Këto të drejta njihen për herë të parë dhe gjejnë pasqyrim në ligjin e ri, pikërisht në nenet 16, 17, 18 dhe 19 të tij.

Ligji i mëparshëm parashikonte që të gjitha çështjet shqyrtohen në seancë gjyqësore me pjesëmarrje të palëve, të kërkuesit dhe subjekteve të interesuara. Edhe në ligjin e ri është ruajtur ky rregull, por siç përcaktohet në nenin 23 të tij, procesi i gjykimit mund të zhvillohet në seancë plenare edhe mbi bazë të dokumenteve, sipas natyrës së çështjeve. Natyrisht kjo përbën një të re që sjell ligji i ri, çka nënkupton zhvillimin e seancës pa pjesëmarrje të palëve. Në ligj, nuk janë përcaktuar rastet se kur ky gjykim mund të zhvillohet pa praninë e palëve, por vetëm thuhet sipas natyrës së çështjeve. Në nenin 71 pika 5, kur trajtohet procedura e interpretimit të Kushtetutës theksohet se “shqyrtimi i kërkesave të tilla mund të bëhet në seancë plenare edhe mbi shqyrtimin e dokumenteve”. Pra, ky është një rast që e lejon ligji, por shprehja e përdorur në nenin 23 “sipas natyrës së çështjes”, nuk përbën pengesë për Gjykatën Kushtetuese që të zhvillojë seancën plenare mbi bazën e dokumenteve edhe në raste të tjera. E rëndësishme është që të vlerësohet me kujdes plotësia e dokumenteve të paraqitura dhe nëse palët nuk kanë se çfarë të shtojne tej përmbajtjes së këtyre dokumenteve. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese edhe pse ka vendosur që një çështje të shqyrtohet mbi bazën e dokumenteve, ajo nuk është e ndaluar, që po të jetë e nevojshme, të rihapë procesin e të zhvillojë gjykimin me pjesëmarrje të palëve. Gjykimi mbi bazë dokumentesh njihet edhe në veprimtarinë e gjykatave të tjera.

Në ligjin e mëparshëm nuk kishte ndonjë dispozitë ku të përcaktohej se çfarë duhej të përmbante kërkesa që i paraqitet për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese. Në nenet 28 e 29 të ligjit të ri përmenden shprehimisht se çfarë duhet të përmbajë kërkesa dhe dokumentet që sipas rastit duhet t'i

bashkëlidhen kërkesës. Në pamje të parë, duket sikur këto rregulla nuk kanë ndonjë vlerë për t'u theksuar, por në të vërtetë ato kanë rëndësi në dy aspekte: Së pari, sepse bëhet më e qartë se kur kërkesa është e plotë dhe duhet vendosur për kalimin në seancë dhe kur ajo nuk është e plotë dhe i duhet kthyer për plotësim palës kërkuese. Së dyti, për ta dalluar kërkesën nga ankesat, letrat ose parashtrirat e ndryshme, të cilat nuk janë objekt shqyrtimi dhe duhen trajtuar administrativisht. Përcaktimi në ligj i përmbajtjes së kërkesës shmangu edhe ndonjë paqartësi që ka ekzistuar më parë lidhur me mënyrën e veprimit për këto probleme.

Në lidhje me afatin e paraqitjes së kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, ligji i ri sjell ndryshime të rëndësishme. Sipas ligjit të mëparshëm, nenet 35 e 36, kërkesat para Gjykatës Kushtetuese nuk kishin afat për paraqitje, me përjashtim të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individit, të cilat duhej të paraqiteshin brenda 6 muajve nga konstatimi i shkeljes ose nga data e vendimit të organit përkatës shtetëror. Ligji i ri këtë afat e ka zgjatur në dy vjet, nisur nga dëshira për një mbrojtje më të mirë të lirive dhe të drejtave të njeriut. Por, me interes është se në ligjin e ri, është vendosur afat edhe për paraqitjen e kërkesave për pajtueshmërinë e ligjit ose aktit normativ me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas nenit 50 të ligjit, ky afat është 3 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit ose aktit normativ. Me vendosjen e një afati të tillë, që më parë nuk ka ekzistuar, ligjvënësi është nisur nga mendimi për të ruajtur stabilitetin dhe për të mbrojtur marrëdhëniet juridike të krijuara si rezultat i veprimit të ligjit, sepse siç ka ndodhur, pranë Gjykatës Kushtetuese janë paraqitur kërkesa për shfuqizimin e ligjeve të nxjerra 7-8 vjet më parë, shfuqizimi i të cilave mund të krijonte komplikime më të rënda të marrëdhënieve juridike.

Në nenin 38 të ligjit të mëparshëm trajtoheshin rregullat për shqyrtimin paraprak të kërkesave. Neni 31 i ligjit të ri i ka plotësuar dhe qartësuar më mirë këto rregulla, sidomos në tre aspekte: për shkaqet e kthimit të kërkesës për plotësim me vendim të trupit gjykues, për mënyrën e kalimit

të çështjes në seancë plenare nga trupi gjykues ose mbledhja e gjyqtarëve dhe ajo që ka më shumë rëndësi është plotësimi i bërë dispozitës së, në të gjitha rastet e shqyrtimit paraprak të kërkesave, trupi gjykues ose mbledhja e gjyqtarëve, marrin në shqyrtim vetëm plotësinë e kërkesës, juridiksionin dhe legjitimitimin dhe nuk shqyrtojnë zgjidhjen në themel të çështjes, që është detyrë e seancës plenare.

Në ligjin e ri janë vendosur dy dispozita të reja, nenet 34 e 35 për të drejtat dhe detyrat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues. Ndër të drejtat përmendim: e drejta për të marrë pjesë në shqyrtimin e çdo çështjeje, veç rasteve kur e ndalon ligji, e drejta që të njihet me gjithë materialet e çështjes, e drejta që të kërkojë shpjegime e t'u bëjë pyetje pjesëmarrësve ose dëshmitarëve, e drejta të marrë pjesë në bisedimet përfundimtare e të shfaqë lirisht mendimin për mënyrën e përfundimit të çështjes. Ndër detyrat përmendim atë të përgatitjes së çështjes për gjykim, si dhe marrjen e masave për zhvillimin e seancës plenare, detyra që të votojë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe detyra të ruajë sekretin e diskutimeve dhe të votimit. Kuptohet që edhe këto dispozita janë vendosur në ligjin e ri, sepse i ka diktuar nevoja e punës së Gjykatës Kushtetuese.

Në ligjin e mëparshëm nuk parashikoheshin rregulla për mënyrën e njoftimit të palëve dhe për pjesëmarrjen e tyre në seancë plenare. Në nenin 38 të ligjit të ri janë vendosur rregulla të qarta, duke u përcaktuar mënyrat e njoftimit të palëve, afatin e njoftimit, personin e ngarkuar për bërjen e njoftimeve, shtyrjen e gjykimit për mungesë njoftimi dhe gjykimin në mungesë kur palët pa shkaqe të përligjura nuk paraqiten në ditën dhe orën e caktuar në seancë plenare.

Përmirësime u janë bërë neneve 25 e 32 të ligjit të mëparshëm me nenet 43 e 44 të ligjit të ri në lidhje me rregullat e radhën e veprimeve gjatë zhvillimit të seancës plenare, si dhe për shkaqet dhe mënyrën e veprimit për riçeljen e seancës plenare. Po kështu, është përmirësuar përmbajtja e nenet 33 të ligjit të mëparshëm me nenin 45 të ligjit të ri,



përsa i përket shkaqeve dhe rregullave për pezullimin nga Gjykata Kushtetuese të zbatimit të ligjit ose aktit që i është paraqitur për shqyrtim. Sipas dispozitës së re, pezullimi mund të vendoset edhe mbi kërkesë të palëve, pezullimi mund të vendoset edhe para seancës plenare me vendim të mbledhjes së gjyqtarëve ose edhe gjatë seancës. Vendimi i pezullimit i njoftohet organit që ka nxjerrë ligjin ose aktin normativ dhe bëhet publikimi i tij. Gjithashtu, në vendimin përfundimtar të saj Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit, natyrisht kur nuk e ka hequr më parë atë.

Kreu VII për procedurat e veçanta përmban dispozita krejt të reja, që nuk kanë ekzistuar në ligjin e mëparshëm.

Në nenin 132 pika 1 të Kushtetutës thuhet se Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, mirëpo, sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka edhe disa kompetenca të tjera, të cilat nuk lidhen gjithnjë me shfuqizimin e akteve, por edhe me marrjen e vendimeve ose nxjerrjen e urdhërimeve në varësi të çështjeve që shqyrton. Kështu, Gjykata Kushtetuese vendos se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes për të cilin ka lindur mosmarrëveshja për kompetencë. Gjykata Kushtetuese urdhëron ndalimin e veprimtarisë së partive politike kur kjo veprimtari vjen në kundërshtim me Kushtetutën, ose urdhëron çregjistrimin e tyre. Gjykata Kushtetuese deklaron shkarkimin e Presidentit të Republikës nga detyra ose deklarimin e papajtueshmërisë së funksioneve të Presidentit. Pra, në këto dhe raste të tjera, Gjykata Kushtetuese nuk ka të bëjë gjithnjë me shfuqizim të aktit. Nga ana tjetër, në nenin 1.4 të Kushtetutës janë përcaktuar subjektet që e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, por jo të gjitha këto subjekte mund ta vënë në lëvizje për çdo çështje. Në ndonjë rast, siç përmendet në Kushtetutë, ka dhe vendime të organeve të tjera që e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Kështu, për shkarkimin nga detyra të Presidentit, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të gjyqtarit kushtetues, Gjykata

Kushtetuese vihet në lëvizje nga vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Kështu që procedurat e veçanta përcaktojnë jo vetëm se çfarë vendimi merr Gjykata Kushtetuese për çdo rast konkret, por edhe cilat subjekte e venë atë në lëvizje dhe kush janë subjektet e interesuara për secilin rast. Pra, ligji, brenda kuptimit të Kushtetutës, ka synuar që të qartësojë e të ligjërojë veprimet e Gjykatës Kushtetuese me qëllim që të shmangen keqkuptimet ose mungesa e uniformitetit në vendimet e saj.

Në Kreun VIII, ku parashikohen dispozitat mbi vendimet e Gjykatës Kushtetuese, edhe në këtë pjesë ka dallime në krahasim me ligjin e mëparshëm.

Momenti i parë: Sipas ligjit të mëparshëm, kur ndonjë nga gjyqtarët, që kishte marrë pjesë në gjykim, mungonte gjatë bisedimit ose votimit, Gjykata merrte vendim pa praninë e tyre, mjafton që të formohet shumica e anëtarëve. Ligji i ri këtë çështje e zgjidh më mirë. Ky ligj nuk lejon marrjen e vendimit, kur mungon ndonjë nga anëtarët në bisedim ose votim, por kërkon doemos shtyrjen e mbledhjes për një datë tjetër. Vetëm pas shtyrjes, nëse pjesëmarrja nuk sigurohet brenda një afati të arsyeshëm, mund të vendoset për çështjen.

Ky rregull i ri siguron pjesëmarrje sa më të gjerë të anëtarëve në marrjen e vendimeve, nuk lejon përjashtimin nga detyra për të marrë pjesë në zgjidhjen e çështjeve të gjyqtarëve që, për arsye të përkohëshme, nuk mund të jenë të pranishëm në bisedime e në votim, ashtu sikurse nuk lejon që anëtarë të veçantë, të shmangen nga marrja e vendimeve.

Momenti i dytë lidhet me sqarimin që bën ligji i ri për çastin e marrjes së vendimit. Ka pasur mendime se vendimi quhet i marrë jo kur votohet për të, por kur nënshkruhet. Ligji i ri, për të shmangur çdo keqkuptim, në nenin 75 përcakton se “vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pas votimit konsiderohet i marrë dhe nuk mund të ndryshohet”. Pra, momenti i marrjes së vendimit është ai i votimit të tij.

Së fundi, dëshiroj të theksoj se një e re tjetër që sjell ligji i ri është përcaktimi i efekteve juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur shfuqizohet ligji ose akti normativ. Këto vendime kanë fuqi nga data e hyrjes së tyre në fuqi, pra për të ardhmen, me përjashtim të rasteve që përmenden në shkronjat “a”, “b”, “c” të nenit 76.

# Vendi dhe roli i Gjykatës Kushtetuese në shtetin demokratik

***Gjykata Kushtetuese si një mekanizëm i ri në vendet në tranzicion***

*Dr. Xhezair Zaganjori*

Pothuajse në të gjitha shtetet demokratike ose që janë në rrugën e demokracisë parashikohet sot krijimi i një gjykate kushtetuese. Organizimi, kompetencat dhe procedurat e funksionimit të saj përcaktohen, si rregull, me kushtetutë ose me ligje të veçanta. Në përgjithësi, ajo ka funksion të dyfishtë, si gjykatë dhe si organ kushtetues. Në të dy këto funksione, gjykata kushtetuese shërben kryesisht si garantuese dhe mbrojtëse e posaçme e rendit kushtetues të vendit. Si rregull, përmes saj bëhet i mundur realizimi sa më efektiv i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve dhe kontrolli i pushtetit shtetëror në përgjithësi, funksione këto tepër të rëndësishme dhe më se të domosdoshme në shtetin demokratik. Me të drejtë vlerësohet se gjykata kushtetuese është garantuesja dhe mbrojtësjja më e mirë e lirisë dhe e kushtetutës.

Vendimet e saj janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha pushtetet, përfshirë edhe pushtetin legjislativ. Madje, kontrolli i përputhjes së ligjeve të parlamentit me kushtetutën e vendit është një nga detyrat dhe kompetencat themelore të gjykatës kushtetuese. Duhet theksuar se, në përgjithësi, edhe vetë gjykata kushtetuese, si një instrument i veçantë juridik në shtetin demokratik, është një mekanizëm relativisht i ri. Shfaqja e këtij mekanizmi, veçanërisht në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, është bërë lidhur

ngushtë me kërkesën, nevojën dhe dëshirën për respektimin sa më të mirë të të drejtave të njeriut dhe përsosjen e parimeve të shtetit demokratik, veçanërisht të parimeve: a) të shtetit juridik dhe b) të ndarjes së pushteteve.

Ndoshta është me interes të theksohet se bum-it të krijimit të gjykatave kushtetuese në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore i ka paraprirë në vitet '30 një debat mjaft interesant në planin akademik. Mendoj se nuk do të ishte e tepërt të përmendeshin shkurtimisht dy linjat kryesore të këtij debati, konkretisht, linjës që ishte pro krijimit të këtij mekanizmi të veçantë juridik dhe linjës që ishte kundër krijimit të saj.

Sipas këtyre të fundit, pra akademikëve që kundërshtonin krijimin e gjykatës kushtetuese, institucioni i gjykatës kushtetuese bie në kundërshtim me parimin demokratik të ndarjes së pushteteve. Vlerësohej se në përputhje me teorinë e ndarjes së pushteteve, veçanërisht pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv duhet të kontrollojnë ndërsjelltas njëri-tjetrin (teoria e drejtkëndëshit), por jo të kontrollohen nga një instancë ose mekanizëm i tretë, pra, nga gjykata kushtetuese. Konstitucionalisti i njohur gjerman Carl Schmidt shkante edhe më tej kur theksonte se krijimi i gjykatës kushtetuese do të prishte edhe vetë elasticitetin dhe fleksibilitetin e kushtetutës. Sipas tij, shumë nene të kushtetutës arrihen si rezultat i kompromisit ndërmjet forcave politike. Për këtë arsye, interpretimi i këtyre normave nga gjykata kushtetuese vetiu do të anonte nga njëri ose tjetri pozicion i shprehur nga parti politike të caktuara në pushtet ose në opozitë. Për pasojë, ai theksonte se kështu, padashur, do të kishin një farë politizimi të veprimtarisë së kësaj gjykate. Ai vlerësonte se një gjykatë e tillë do të mbartte gjithnjë rrezikun e dyfishtë: 1) të politizimit të drejtësisë dhe 2) të juridifikimit të politikës. Bazuar në këtë arsyetim ai shton më tej se një drejtësi e politizuar nuk mund të konsiderohet më si veprimtari e mirëfilltë, që i përket pushtetit gjyqësor dhe, nga ana tjetër, një politikë, së cilës mund t'i vihen kufij nga gjykata kushtetuese, nuk do të ishte në gjendje të reagojë aq dhe sa duhet ndaj dukurive të jetës politike e shoqërore të vendit. Schmidt theksonte, gjithashtu, se veprimtaria e gjykatës kushtetuese mënjanon edhe

përgjegjësinë politike, sepse e drejta e fjalës së fundit tregon se kush është sovrani i vërtetë i vendit. Ai thekson se në shtetin demokratik sovraniteti nuk mund t'i lihet në dorë drejtësisë, sepse kjo është i vetmi institucion i shtetit që për shkak të pavarësisë dhe asnjansisë së vet nuk është përgjegjëse para askujt. Qeveria mund të shkarkohet nga parlamenti dhe parlamenti mund të zëvendësohet përmes zgjedhjeve të reja, ndërsa drejtësia mbetet e paprekshme për shkak të nevojës për pavarësi, sepse përndryshe do të humbiste kuptimin e vet një nga kolonat kryesore të ndarjes së pushteteve, pra pushteti gjyqësor. Schmidt përfundon duke thënë se “një veprimtari gjyqësor e pavarur, por që mund të marrë edhe vendime politike, duke mos mbajtur përgjegjësi politike, të kujton monarkët ose dikatorët.”

Krejt ndryshe mendonin dhe shpreheshin në vitet '30 përkrahësit e idesë së krijimit të gjykatës kushtetuese, mes të cilëve dallohet një nga kolosët e mendimit juridik modern, austriaku Hans Kelzen. Pikënisje e tyre është argumenti mbi përparësinë absolute të normave kushtetuese në hierarkinë e përgjithshme të normave juridike. Për mbikëqyrjen dhe respektimin e kësaj hierarkie mendonin se është e domosdoshme të krijohet një instancë ose mekanizëm i veçantë me detyra e kompetenca të gjera kontrolli mbi tri pushtetet. Sipas këtij qëndrimi, një instancë e tillë mund të jetë vetëm gjykata kushtetuese. Përmes saj mbrohet kushtetuta, garantohet zbatimi i saktë dhe i njëllojtë i normave kushtetuese nga të tri pushtetet, si dhe shmanget rreziku i ushtrimit të pushtetit shtetëror në mënyrë arbitrare.

Përkrahësit e gjykatës kushtetuese sjellin edhe një argument tjetër mjaft interesant. Ata theksojnë se parimisht në shtetin demokratik ekzekutivi zgjidhet nga parlamenti, po në raste të caktuara edhe vetë ai mund të iniciojë shpërndarjen e parlamentit. Nga ana tjetër, parlamenti kontrollon punën e qeverisë dhe mund ta rrëzojë atë. Ky është kuadri klasik, por për këdo është më se e qartë se në regjimin parlamentar sot, praktikisht, kemi bashkëpunim të ngushtë të shumicës parlamentare me qeverinë. Në këtë regjim, normalisht, nuk mund të pritët që qeveria të veprojë në kundërshtim me vullnetin e

shumicës parlamentare. Shumica e legjislativit dhe ekzekutivi janë kështu identikë nga pikëpamja e vullnetit politik. Ky përqendrim i pushtetit do të ishte i rrezikshëm për demokracinë, sepse pushteti do të bëhej i pakontrollueshëm dhe zbatimi e interpretimi i normave kushtetuese do të bëhej në mënyrë arbitrare, sipas interesit dhe qëllimeve të shumicës. Në këto kushte, detyrat klasike të parlamentit, në kuadër të zbatimit të parimit të ndarjes së pushteteve, mbetet t'i realizojë opozita, por që praktikisht është e pambrojtur siç duhet, sepse përbën pakicën. Forca e kartonit, si rregull, është pothuajse gjithnjë kundër saj.

Së fundi, përkrahësit e mendimit të gjykatës kushtetuese theksojnë se një mekanizëm i tillë është me rëndësi të veçantë dhe në funksion të njohjes dhe garantimit sa më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, kundër veprimtarisë arbitrare dhe subjektivizmave që mund të manifestohen nga të tri pushtetet.

Pikërisht për këto arsye, në planin akademik theksohet sot se, për të garantuar respektimin e kushtetutës, ndarjen e pushteteve në shtet dhe të drejtat dhe liritë e shtetasve, gjithnjë lind nevoja për një arbitër të paanshëm, për një pushtet të katërt asnjans, i cili interpreton kushtetutën e vendit në mënyrë autentike dhe është në gjendje t'u japë vendime të gjithë pushteteve të tjerë, përfshirë edhe drejtësinë. Normalisht këtë detyrë mund ta kryejë mirë vetëm një gjykatë kushtetuese. Ka raste që kjo detyrë përmbushet në një masë të konsiderueshme edhe nga presidenti i republikës. Shpesh ai shfaqet si pushtet i katërt asnjans dhe si forcë barazpeshuese që angazhohet për respektimin e kushtetutës, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore dhe zbatimin e parimit të ndarjes së pushteteve. Në raste të tjera kjo detyrë kryhet së bashku nga presidenti i republikës dhe nga gjykata kushtetuese. Sidoqoftë, në këtë rast gjykata kushtetuese mbetet gjithnjë mekanizmi kryesor i specializuar dhe i ngarkuar posaçërisht për realizimin e funksioneve të përmendura më sipër.

Praktikisht për gjykatën kushtetuese bëhet fjalë për herë të parë në Kushtetutën Austriake të vitit 1920 (neni 137 dhe neni 148). Nxitje dhe

fymëzim kryesor për krijimin e kësaj gjykate shërbeu në atë kohë teoria e juristit të shquar austriak Hans Kelsen. Megjithatë, gjykata kushtetuese në kuptimin klasik për herë të parë zë vend tepër të veçantë në Kushtetutën Gjermane (ligji themelor i vitit 1949). Kreu i nëntë i kësaj Kushtetute i kushtohet tërësisht përbërjes, organizimit dhe kompetencave të kësaj gjykate (nenet 92, 93, 94). Me të drejtë thuhet shpesh sot se Gjykata Kushtetuese Gjermane simbolizon me të vërtetë përparësinë e ligjit në shtet dhe shoqëri. Ajo ka qenë tepër aktive dhe, me gjykime të çështjeve të shumta që ka bërë që nga krijimi i saj më 1951 e deri më ditët tonë, ka luajtur rol tepër të rëndësishëm në zbatimin e parimit të rëndësishëm të ndarjes së pushteteve, për forcimin e pavarësisë së gjykatave dhe të veprimtarisë së administratës shtetërore në përputhje me ligjin, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve për mbrojtjen e të drejtave të opozitës, për garantimin e një shoqërie të lirë dhe mbajtjen hapur të procesit politik përmes konkurrimit të barabartë të partive politike, për ruajtjen e rendit kushtetues dhe të demokracisë në Gjermani etj. Si një ndër ndihmësat tepër të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese Gjermane vlerësohet sidomos mbrojtja e rendit juridik nga ligjet që mund të bien në kundërshtim me Kushtetutën. Faktikisht kjo kompetencë, ndër të tjera, i krijon mundësi reale veçanërisht opozitës që të jetë aktive në politikë dhe të luajë rolin që i takon në shtetin demokratik. Opozita e shfrytëzon këtë rast edhe si mundësi për të afirmuar programin dhe objektivat e saj. Konstitucionalisti i njohur gjerman Raselhorn thekson ndër të tjera se “Po të hiqej kjo e drejtë (pra, po të hiqej e drejta e mundësisë së paraqitjes nga opozita në gjykatën kushtetuese të çështjeve lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve dhe çështje të tjera), klima ndërmjet pozitës dhe opozitës do të histerizohej. Përmes kësaj të drejte opozita i kujton pozitës se në demokraci pushteti kufizohet në ligj.”

Në përgjithësi mund të thuhet se gjykata kushtetuese është faktor i rëndësishëm qetësues, sidomos në raportet pozitë-opozitë. Por natyrisht që këtë rol ajo mund ta luajë më së miri vetëm nëse çështjet i trajton me



objektivitet, larg pasioneve politike dhe vetëm në kuadër dhe në bazë të ligjit.

Përveç sistemit gjerman, pas Luftës së Dytë Botërore gjykata kushtetuese është njohur si institucion i veçantë edhe në një sërë kushtetutash të tjera të Europës. Si të tilla mund të përmenden Kushtetuta Italiane e 1947-ës, Kushtetuta Spanjolle e 1978-ës, Kushtetuta Portugeze e 1982-it, Ligji Kushtetues Belg për Reformën Institucionale i vitit 1980, kushtetutat turke të 1961-it dhe 1982-it. Me ndryshime të vogla, modeli evropian i gjykatës kushtetuese është bazuar në dy-tre dhjetëvjeçarët e fundit edhe në kontinente të tjera. Kështu për shembull, gjykata kushtetuese janë krijuar edhe në Kili (1980), Peru (1980), Guatemala (1982), Kore e Jugut (1988), Marok (1992), Tunizi (1990), Afrikë e Jugut (1997) etj.

Synimi dhe dëshira për vendosjen e plotë të demokracisë, për garantimin e të drejtave dhe të lirive themelore të shtetasve, për vendosjen e shtetit të së drejtës dhe respektimin e ndarjes së pushteteve, i ka nxitur edhe vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të riprodhojnë zgjidhjen perëndimore në krijimin e gjykatës kushtetuese. Kështu, më 1986, një gjykatë e tillë u krijua për herë të parë në Poloni, më 1989 në Hungari, më 1990 në Kroaci, më 1991 në Rusi, Sllovani, Bullgari, Rumani e Maqedoni, më 1992 në Shqipëri dhe në Lituani, më 1993 në Sllovaki e Çeki etj. Me ndryshime të vogla, vendi, kompetencat dhe juridiksioni i tyre përafrojnë me gjykatat kushtetuese të Europës Perëndimore. Sidoqoftë, si model kryesor ka shërbyer pothuajse gjithnjë Gjykata Kushtetuese e R.F.Gjermane.

Përgjithësisht vlerësohet se krijimi dhe funksionimi i gjykatave kushtetuese, në vendet që janë në rrugën e tranzicionit, ka qenë një faktor i rëndësishëm pozitiv në procesin e vështirë të shkëputjes nga e kaluara dhe në orientimin drejt ndërtimit të një demokracie liberale. Vendimet e shumta që janë dhënë prej tyre, në një kohë relativisht të shkurtër, janë dëshmia më e mirë për këtë. Sidoqoftë, analistët theksojnë se ka edhe mjaft raste ku orientimi dhe funksionimi i tyre, në përputhje me standardet perëndimore dhe qëllimin për të cilin janë krijuar, mbetet ende problematik. Vlerësohet se

në disa prej tyre, në forma e mënyra të ndryshme, është i dukshëm presioni i partisë ose i partive në pushtet. Kjo bëhet jo vetëm përmes zgjedhjes së kuadrit (gjqytarëve), por edhe përmes ndërhyrjeve ose ndikimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për çështjet konkrete që shqyrtojnë dhe gjykojnë këto gjykata. Nga ana tjetër, puna e gjykatave kushtetuese në këto vende vështirësohet shpesh edhe për shkak të marrëdhënieve dhe politikës konfliktuale që mbisundon ende në shoqëritë paskomuniste. Me të drejtë theksohet se ligjet kanë ndryshuar, por megjithatë raportet politike e sociale mbingarkohen nga qëndrime antidemokratike e mbeturina të kulturës e mendësisë totalitare, që përjashtojnë çdo ide pajtimi dhe bashkëpunimi në interes të shoqërisë dhe shtetit demokratik. Për pasojë, mendohet se ende mbetet shumë për të bërë që gjykatat kushtetuese në vendet në tranzicion të forcojnë identitetin dhe pavarësinë e tyre dhe të luajnë rolin që u takon në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimin e konsolidimit e shtetit demokratik.

# Subjektet kryesore që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

*Dr.Maksim R.Haxhia  
Av.Artan Hajdari*

Ligji kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime dhe plotësime në ligjin nr.741, datë 29.4.1941 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” konstituoï krijimin për herë të parë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Ky ligj, që përcaktoi qëllimin e krijimit të kësaj gjykate, përbërjen dhe kompenat e saj, përcaktoi edhe mënyrën se si vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese dhe subjektet që e vënë atë në lëvizje.

Vend të rëndësishëm midis dispozitave kushtetuese zë problemi lidhur me subjektet kryesore që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Sipas nenit 25/1 të këtij ligji është dhënë përcaktimi se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë ose me nismën e saj. Kjo dispozitë i jep të drejtë asaj për t’u vënë në lëvizje, duke përdorur autoritetin e vet për t’u legjitimuar në gjykimin e çështjeve të ndryshme që hyjnë në kompetencën e saj dhe të përcaktuara në mënyrë të shprehur në nenin 24 të këtij ligji.

Sipas paragrafit të dytë të këtij neni, subjektet që kanë të drejtë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese janë Presidenti i Republikës, një grup parlamentar, një e pesta e deputetëve, Këshilli i Ministrave, gjykatat, organet vendore të pushtetit, si dhe çdo person lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të tij, të parashikuara nga Kushtetuta. Ky përcaktim, që Dispozitat

Kryesore Kushtetuese i bëjnë rrethit të subjekteve që legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, është me karakter të përgjithshëm dhe nuk përcakton rastet se kur këto subjekte mund t'iu drejtohen asaj gjykate.

Dispozitat Kryesore Kushtetuese në nenin 28 përcaktojnë se organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, procedura e zgjidhjes të çështjeve, si dhe çështjet e tjera themelore për kryerjen e detyrave të saj rregullohen me ligj. Ishte i pajustificueshëm moszbatimi i kësaj dispozite ligjore për miratimin e një ligji organik për Gjykatën Kushtetuese, i cili do të parashikonte organizimin dhe funksionimin e saj.

Në rastin e kërkesave të bëra nga individët (neni 25/2), përcaktimi i bërë nga këto dispozita është më i plotë dhe lidhet me shkeljen e lirive dhe të drejtave të tyre, të parashikuara nga ligji kushtetues. Pavarësisht nga ky përcaktim, ende nuk do të kemi një rregullim të plotë, që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të individit. Ligji nr. 7692, datë 31.3.1993 e zgjidhi përfundimisht këtë zbrazëti, që ishte një çast i brishtë, do të thoshim, për parimet e një shteti që hyri në rrugën e demokracisë dhe në themel të organizimit të tij vuri respektimin e të drejtave të individit në shoqëri.

Një trajtim të veçantë që e gjejmë në këto dispozita është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetues me nismën e vet, e cila ka qenë deri në miratimin e Kushtetutës, një çast i veçantë në organizimin dhe funksionimin e këtij organi kushtetues. Kjo kërkesë e ligjit të kohës është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm klasik, ai i vënies në lëvizje të një autoriteti gjyqësor me kërkesë të palëve; në të kundërt, e drejta e pretenduar si e shkelur nuk mund të merret në mbrojtje nga organi kompetent me nismën e vet. E drejta e Gjykatës Kushtetuese, për t'iu vënë në lëvizje me nismën e vet, është marrë nga organizimet shtetërore me një kushtetutë dhe gjykatë kushtetuese relativisht të vjetër, sidomos nga ato vende europiane që e njohin një organizim të tillë.

Në periudhën e parë të krijimit dhe të funksionimit të saj, Gjykata Kushtetuese nuk e ka ushtruar asnjëherë këtë kompetencë që i jepnin

Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Vendimi i parë i marrë nga Gjykata Kushtetuese, duke u vënë në lëvizje me nismën e vetë, është ai me nr. 34, datë 24.1996. Sipas këtij vendimi, gjykata u vu në lëvizje me nismën e vetë, duke u nisur nga një ndryshim që iu bë ligjit nr. 7573, datë 16.6. 1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”. Sipas nenit 16 të ligjit nr.8151, datë 12.9.1996, i cili ndryshoi ligjin e mësipërm dhe përcaktoi Gjykatën Kushtetuese si organin që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhje për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor. Sipas nenit 40 të ligjit të mëparshëm, kjo kompetencë më parë i ishte lënë Gjykatës së Kasacionit. Gjykata Kushtetuese, duke u nisur nga kompetencat që i jepte ligji nr.7561, datë 20.4. 1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29. 4. 1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””, e shfuqizoi nenin 16 të ligjit që i dha kompetencën e shqyrtimit të ankimeve kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si antikushtetues, duke e lënë të drejtën e ankimit me të njëjtën përmbajtje që përcaktonte ligji i vitit 1992 “Për zgjedhjet e Organeve të Pushtetit Lokal”. Arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese në këto raste, të vënies në lëvizje për gjykim me nismën e vetë, mendojmë se është i drejtë, pasi pika 7 e nenit 24 të paketës kushtetuese përcaktonte qartë se Gjykata Kushtetuese “zgjidh çështjet për ligjshmërinë e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, të deputetëve, si dhe të referendumit popullor, duke shpallur rezultatet përfundimtare “. Në këtë kuptim kompetencat e saj nuk mund të ndryshohen, ngushtohen ose zgjerohen përveçse me ligj kushtetues. Duke mos u zgatur në argumentet e këtij rasti konkret, pasi nëpërmjet tij do të donim të nxirnim në dukje se Kushtetuta e Republikës në nenin 134 të saj e përjashton këtë kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Pas këtij vendimi Gjykata Kushtetuese ka marrë edhe disa vendime të tjera, të cilat i përkasin periudhës së vitit 1997 dhe gjithsej janë pesë të tilla, në të cilat kjo Gjykatë ka përdorur të drejtën ligjore për t’u vënë në lëvizje me nismën e vet. Edhe në ligjin nr. 8373, datë 15.7. 1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë “, në nenin

34 të tij është fiksuar edhe njëherë e drejta e Gjykatës Kushtetuese për t'iu vënë në lëvizje me nismën e vet.

**Një nga subjektet kryesore që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe që parshikohet nga neni 134/a i Kushtetutës është Presidenti i Republikës.** Kjo e drejtë e Presidentit parashikohej edhe nenin 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992. Sipas Dispozitave Kryesore Kushtetuese, shteti shqiptar u përcaktua si republikë parlamentare dhe Kuvendi Popullor zgjidhte me procedura të përcaktuara Presidentin e Republikës. Sipas nenit 24 të këtyre dispozitave, Presidenti i Republikës është kryetari i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit. Sipas statistikave, nga ana e tij Presidenti i Republikës, si një nga subjektet kryesore që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, e ka ushtruar këtë të drejtë vetëm në katër raste, të cilat i përkasin njëri vitit 1997, në vitin 1998, në vitin 2000 dhe i fundit në janar 2002.

Mund të themi se e drejta e Presidentit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese del nga vete pozicioni kushtetues që ka ai si kryetar i shtetit. Kështu, me ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në nenin 28 përcaktohej se “Presidenti i Republikës siguron respektimin e këtij ligji, të ligjeve të tjera dhe të drejtave e lirive të shtetasve”. Me miratimin e Kushtetutës, kompetencat e Presidentit të Republikës janë saksionuar në mënyrë të shprehur qartë, ku ai ka ndër të tjera si kompetencë kryesore edhe atë të respektimit të ligjit themelor të shtetit, të Kushtetutës. Deri me miratimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese nuk kemi patur asnjë rast që Presidenti i Republikës të ketë ushtruar këtë të drejtë. Me miratimin e këtij ligji (neni 34), Presidenti i Republikës kishte të drejtë të bënte kërkesë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese në rastet e parashikuara nga neni 24, pika 1, 2, 3, 4, 5, 6 e 7 të ligjit nr. 7561, datë 29.4.1992. Përcaktimi i kësaj të drejte sipas kësaj dispozite ligjore i bënte më të përcaktuara rastet se kur Presidenti i Republikës do t'i drejtohej Gjykatës

Kushtetuese, në raport me përcaktimin në mënyrë të përgjithshme që i jepte neni 25/2 i ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Me miratimin e ligjit të ri «Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese» kemi të fiksuara procedura të veçanta, në të cilat gjejmë ndër të tjera edhe të drejtën që kanë subjektet e ndryshme që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Kështu, Presidenti i Republikës, sipas nenit 49 të këtij ligji, ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmerisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare. Po kështu Presidenti i Republikës, sipas nenit 52 të ligjit, vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe për shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre. Presidenti i Republikës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe në rastet e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike, rregull ky i përcaktuar në nenin 57 të këtij ligji. Një tjetër rast që Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje nga Presidenti i Republikës është edhe ai, që ka të bëjë me shqyrtimin e zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit. Në këtë rast kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi, për sa kohë vazhdon mandati i deputetit, ndërsa kërkesa për zgjedhshmëri, sipas pragrafit të parë të këtij neni, mund të paraqitet nga Presidenti brenda gjashtë muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë.

Siç thamë më sipër, një nga kompetencat kryesore të Gjykatës Kushtetuese është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj. Në kuptim të kësaj dispozite Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje ndër të tjera me kërkesë të bërë nga Presidenti i Republikës (neni 71 i saj). Në kërkesën e paraqitur nga ana e tij, duhet argumentuar se cila dispozitë ose pjesë e saj kërkohet të interpretohet. Gjithashtu, palë në gjykim do të jetë edhe subjekti që pretendohet se ka interpretuar gabim Kushtetutën. Dhënia në mënyrë të shprehur e këtyre rasteve për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, mendojmë se nuk mund të përjashtojë të drejtën e tij që mund

t'i drejtohet asaj edhe për raste të tjera që burojnë nga kompetencat kushtetuese të tij. Një çast i tillë mendojmë se mund të zgjidhet nga praktika.

**Një subjekt tjetër që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, të cilin nuk e kemi hasur më parë në Dispozitat Kryesore Kushtetuese është edhe Ombucmani ose siç njihet ndryshe me termin kushtetues Avokati i Popullit.** Ky institut kushtetues, i cili e ka traditën e tij në vendet me një kushtetutë të shkruar dhe relativisht të re, ka pasur një zhvillim në ngritje në këto vende si një institucion i rëndësishëm për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga dhunimi që mund t'i bëhen nga parregullsitë e funksionimit të administratës publike.

Ndërsa në ato vende që e njohin dhe që funksionon ky institucion, ai është tepër i zhvilluar dhe tepër aktiv në realizimin e misionit të tij. Në vendin tonë ai është një institucion tepër i brishtë dhe i sapo krijuar. Nuk është pa kuptim fakti që ky institucion kushtetues në Kushtetutën e Republikës është renditur në pjesën e dytë të saj, ku bën pjesë edhe kreu i rëndësishëm për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kjo, mendojmë, edhe për faktin për t'i dhënë misionit të tij kushtetues atë rëndësi që ai duhet të ketë në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit në shoqërinë tonë demokratike nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike. Në këtë kuptim, roli i tij është i rëndësishëm në mbrojtjen e këtyre të drejtave, jo vetëm nëpërmjet denoncimit të tyre pranë organeve të administratës publike, që shkelin këto të drejta, por edhe nëpërmjet mbrojtjes së tyre në rrugë kushtetuese, duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për çështje që kanë të bëjnë me vënien në vend të të drejtës së shkelur.

Ligji nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit" rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni. Në këtë kuptim, si një nga subjektet që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit ka një fushë të gjerë veprimi për t'u legjitimuar në kërkimin e tij para saj dhe në çdo rast vetëm për çështje që lidhen me interesat e objektit të punës së tij. Në nenin 49 të ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, Avokati



i Pupullit përcaktohet si një nga subjektet që kanë të drejtë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, vetëm në ato raste kur ai mund të argumentojë se kërkesa e bërë për çështjen në fjalë lidhet me interesat e objektit të veprimtarisë së tij.

**Një tjetër subjekt sipas nenit 134/b të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është edhe Kryeministri.** Po të shohim trajtimin që i është bërë nga ligji i kohës këtij subjekti, duhet t'i referohemi ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"". Sipas nenit 25/2, si një nga subjektet që mund t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, ishte edhe Këshilli i Ministrave. Nisur nga këto kompetencat kushtetuese të tij, pavarësisht se nuk kanë qënë të përcaktuara rastet se kur ai mund t'i drejtohej Gjykatës, deri me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", Këshilli i Ministrave në kohë të dryshme e ka ushtruar të drejtën e tij dhe i është drejtuar asaj për çështje të ndryshme. Kështu, këtë subjekt e gjejmë që i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese qysh në fillimet e veprimtarisë së saj. Nisur nga statistikat, vendimi nr.2, datë 27.7.1992 i kësaj Gjykate është marrë mbi bazën e kërkesës së bërë nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me objekt ndalimin e veprimtarisë së mëtejshme të organizatës së vetë emëruar "Bashkimi i Kuadrove Ushtarake në Rezervë" si antikushtetuese. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" u përcaktuan edhe rastet kur ky subjekt mund t'i drejtohej Gjykatës. Konkretisht sipas nenit 34/c të këtij ligji, Këshilli i Ministrave mund t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për çështjet e parshikuara nga neni 24 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 e 9 të ligjit 7561, datë 29.2.1992. Miratimi i Kushtetutës, të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në ndryshim me ligjin e mëparshëm, ia ka lënë në mënyrë të

drejtpërdrejtë Kryeministrit, përcaktim ky tepër i drejtë, pasi siç është e parashikuar në nenin 95 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat, prandaj nuk do të ishte normale që për t’iu drejtuar një organi tjetër, siç është Gjykata Kushtetuese, të mblidhej dhe të vendoste në seancë plenare i gjithë kabineti qeveritar. E drejta e Kryeministrit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese del edhe nga përmbajtja e nenit 102 të Kushtetutës, ku thuhet se “Kryeministri përfaqëson Këshillin e Ministrave”. Miratimi i ligjit të ri « Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, në kreun VII të tij, në procedurat e veçanta që ka vendosur për gjykimin e çështjeve kushtetuese, përcakton edhe rastet se kur Kryeministri mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 49 të këtij ligji, në rastet e procedurave të shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, ai është një ndër subjektet që mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Gjithashtu, Kryeministri mund të jetë subjekti i kërkimit në këtë Gjykatë edhe në rastet e pajtueshmërisë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre. Kjo kompetencë e tij është e natyrshme, pasi Kryeministri në emër të Qeverisë Shqiptare, që kryeson është palë në nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që i përkasin sferës së të drejtës ndërkombëtare publike. Kushtetuta e ngarkon atë jo vetëm me një obligim të tillë, por në rastet kur ai mund të arrijë në përfundimin se një marrëveshje e nënshkruar prej tij nuk mund të ratifikohet, ai është i detyruar të njoftojë menjëherë parlamentin, e drejtë kjo që i jepet edhe nga ligji i mësipërm, për t’iu drejtuar në të njëjtën kohë edhe Gjykatës Kushtetuese, në rastet e pajtueshmërisë me Kushtetutën të këtyre marrëveshjeve para ratifikimit. Këtë të drejtë ligji nuk ia ka lënë Kryeministrit në rastet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pasi vetë ligji këtë të drejtë ia ka lënë në mënyrë të shprehur Këshillit të Ministrave. Mendojmë se kjo është një zgjidhje e drejtë e bërë nga ligji i mësipërm dhe në të njëjtën kohë vjen në konformitet me ligjin e kohës. Sipas

ligjit të kohës, e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese në një rast të tillë i përkiste Këshillit të Ministrave dhe jo Kryeministrit.

Kryeministri mund të jetë subjekti i kërimit në Gjykatën Kushtetuese edhe në rastet e procedurave lidhur me mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, si dhe kur mosmarrëveshja ka lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë të tyre. Një kompetencë e tillë del nga neni 54/3 e ligjit, ku thuhet se “kërkesa për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti”. Kryeministri mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese edhe në rastet që kanë të bëjnë me interpretimin e Kushtetutës (neni 71/2).

### KRYETARI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHETIT

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është një nga subjektet që Kushtetuta e përcakton në nenin 134/c, për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Në nenin 25/2 të ligjit 7561, datë 29.4.1992 ky subjekt nuk përmendet ndër subjektet e tjera që kishin të drejtë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Kjo për faktin se deri në këtë kohë ende nuk kishim një koncept kushtetues të këtij institucioni. Me ligjin nr.7596, datë 31.8.1992 “Për një shtesë në ligjin 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”” ai u përcaktua si organi më i lartë i kontrollit ekonomik financiar. Në pjesën e katërmbëdhjetë të saj, Kushtetuta e përcakton më qartë pozicionin kushtetues të këtij organi, jo vetëm si organi më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, por edhe si një institucion që në themel të punës të tij ka vetëm zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjeve. Në këtë kuptim buron edhe e drejta që Kushtetuta i ka dhënë këtij subjekti, që t'i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese për çështje që lidhen jo vetëm me interesat e veprimtarisë së tij, por edhe për çështje të tjera të karakterit të përgjithshëm. Në këtë kuptim, ligji i ri për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, në nenin 49 të tij e përcakton Kryetarin e KLSH-së si një subjekt që i drejtohet Gjykatës

Kushtetuese në rastet e shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare. Neni 52 i ligjit të mësipërm e përcakton Kryetarin e KLSH-së, si një nga subjektet që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese edhe në rastet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre. Kryetari i KLSH-së mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe në rastet e interpretimit të Kushtetutës (neni 71/2 i ligjit), të drejtë që kjo gjykatë e ka nga neni 124/1 i Kushtetutës. Si palë në gjykim në këtë rast ligji përcakton edhe subjektin që pretendohet nga ana e kërkuesit se e ka interpretuar në mënyrë të gabuar Kushtetutën.

#### PARTITË POLITIKE DHE ORGANIZATAT E TJERA

Ky subjekt është përcaktuar në nenin 134/f të Kushtetutës. Për sa i përket përcaktimit që Kushtetuta i bën këtij subjekti, është i qartë kuptimi i kërkesës që mund të ushtrohet nga ana e partive politike, ndërsa me përcaktimin organizata të tjera, duhet t'i referohemi kuptimit që Kodi Civil u jep atyre në nenin 24 e vijues të tij. Kështu, në nenin 24 të këtij Kodi përcaktohet nocioni i personave juridikë privatë, duke përfshirë në të shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin e tyre sipas mënyrës të parashikuar nga ligji.

Ndërsa kuptimin e organizatave të tjera si persona juridikë privatë e gjejmë në përcaktimin që i bën atyre neni 39 i Kodit Civil, por gjithmonë me karakter joekonomik. Sipas nenit 134/2 të Kushtetutës dhe sipas kuptimit të dhënë më sipër edhe organizatat e tjera mund të jenë subjekte për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Kështu, të drejtën e partive politike dhe të organizatave të tjera, për të qënë subjekt i kërkimit në Gjykatën Kushtetuese e gjejmë të përcaktur në nenet 49/2, 52/2, si dhe në nenin 71/2 të ligjit 8577, datë 10.2.2000, por, në të trija rastet e përmendura në këto dispozita, vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

Një tjetër subjekt kryesor, që mendojmë të trajtojmë së fundi në argumentet tona, është edhe ai i përcaktuar në shkronjën « d » të nenit 134 dhe që ka të bëjë me çdo gjykatë sipas rastit të nenit 145 pika 2 e Kushtetutës.

Sipas këtij përcaktimi, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Por në këtë rast gjyqtari kur vëren papajtueshmëri të tillë midis ligjit dhe Kushtetutës ose midis ligjit dhe marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar, pezullon gjykimin e çështjes konkrete dhe ia dërgon për gjykim çështjen Gjykatës Kushtetuese. Po sipas pikës dy të nenit 145, vendimet e marra nga Gjykata Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim për të gjitha gjykatat. Në këtë kuptim, Kushtetuta jonë pranon sistemin e diskrecionit të përgjithëshëm dhe jo atë të diskrecionit të shpërndarë, ku gjyqtari zbaton drejtpërsëdrejti dispozitat kushtetuese, kur vëren se ligji bie në kundërshtim me të. Një sistem i tillë vihet re në sistemin gjyqësor federal të ShBA-së

Në rastin e pezullimit të gjykimit të çështjes nga ana e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, kur ato vërejnë se ligji vjen në kundërshtim me Kushtetutën, një kërkesë e tillë mund të bëhet nga palët në gjykim dhe mund të vlerësohet si e drejtë nga ana e gjykatës kur vëren se kërkesa është e bazuar dhe ka argumente, por në të njëjtën kohë gjykata, edhe pa bërë kërkesën pala e interesuar, mund të vlersojë vetë faktin për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i marrë nga ana e Gjykatës Kushtetuese mbi kërkesën e bërë, do të jetë absolutisht i vlefshëm edhe për gjykatat e tjera, për çështje të tilla që mund të jenë të ngjashme, t'i japin të njëjtën zgjidhje. Gjithashtu, mund të themi se me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese janë të lidhura edhe organet e tjera të administratës shtetërore.

# Disa refleksione mbi një vendim kundër-obstruksion të Gjykatës Kushtetuese

*Prof. As. Aurela Anastasi*

Ndoshta për koincidencë, në vitin e 10-të të krijimit të saj, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka përballuar një vëllim të madh pune dhe ka shqyrtuar mjaft çështje. Disa prej tyre janë servitur nga zhvillimet e fundit politike në vend. Kjo ngarkesë nuk ka ardhur për të keq, pasi i ka dhënë Gjykatës më shumë mundësi të riafirmohet si organ garantues i ekuilibrit të pushteteve dhe të institucioneve të shtetit, si garantuese e respektimit të Kushtetutës, apo si një nga mjetet në duart e opozitës, me qëllim që ajo të sigurojë konstitucionalisht rolin e saj. Gjithashtu, vendimet e kësaj gjykate kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në Jurisprudencën shqiptare. Madje, edhe rastet e eksperiencave të debatueshme apo të kontestueshme që kanë lindur si rezultat i vendimeve të saj, nuk e kanë zbehur këtë kontribut, aspak. Në këta 10 vjet, në lëmin kushtetues, ka patur kërkesa e nevoja të vazhdueshme, për të cilat është shkruar pak. Prandaj spikat në mënyrë të pamohueshme roli i Gjykatës Kushtetuese edhe në Doktrinën juridiko-kushtetuese shqiptare. Me arsyetimet e vendimeve të saj, ajo është bërë shpesh nxitëse e debatit shkencor.

Në këtë shkrim të shkurtër, dëshiroj të parashtroj disa refleksione, mbi një nga vendimet më të fundit të Gjykatës Kushtetuese, vendimin Nr.6, dt.18.01.2002<sup>1</sup>. Ky vendim i përket kërkesës së paraqitur nga Presidenti i

<sup>1</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.6, dt.18.01.2002, Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.1, 2002

Republikës, me objekt “Interpretimi i neneve 98, 99 e 106 të Kushtetutës”. Nga momenti që u shpall nga Gjykata, ai ngjalli mjaft interes jo vetëm midis juristëve, por edhe midis qytetarëve, për shkak të përmbajtjes së tij, disi të veçantë. Duke lexuar këtë vendim, nuk ka sesi të mos reflektosh në lidhje me disa probleme të rëndësishme me karakter juridik e kushtetues. Ai mbetet një vendim me mjaft mesazhe, disa prej të cilave po i paraqes si më poshtë:

**Së pari, ky vendim mund të konsiderohet padyshim, si një vendim anti-obstruksion.** “Duke mos shqyrtuar dekretet e Presidentit, pra duke mos ushtruar Kuvendi të drejtën dhe detyrën e tij, krijohet një precedent i rrezikshëm për funksionimin e shtetit dhe qeverisjen e vendit” (nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese).

Sikurse është bërë e njohur ndodhia parlamentare, Kuvendi u thirr disa herë në seancë plenare, por nuk u arrit të formohej *quorumi*, pra, numri minimum i deputetëve për të marrë vendimin. Natyrisht kjo nuk ishte rastësi dhe, mosarritja e *quorumit* të domosdoshëm në Parlament shprehu vullnetin politik të një pjese të deputetëve të shumicës, të cilët ishin kundër dekretëve të Presidentit. Por, a është e ligjshme kjo mënyrë e shprehjes së vullnetit nga ana e tyre? A nuk përbën kjo mënyrë, një shmangie të vullnetshme nga parimi kryesor i demokracisë së shumicës? Në fakt, kjo mënyrë veprimi nuk është krejt e panjohur, madje në teorinë kushtetuese ka edhe një emër. **Këtu është fjala për atë që quhet obstruksionizëm parlamentar në kuptimin teknik të fjalës.** Në kuptimin e tij primar, ai është një mjet që përdoret zakonisht, nga opozita parlamentare me qëllim që të vonohet, të pengohet apo, të ndalohet e të paralizohet formimi i vullnetit parlamentar. Në historinë e shtetit shqiptar, ruan ende karakter historik, rasti i parë i obstruksionit të opozitës parlamentare në vitin 1923. Ky obstruksion kishte qëllim që të pengonte miratimin e ligjit për zgjedhjet, sipas variantit të paraqitur nga qeveria e kryesuar nga Ahmet Zogu, i cili ishte kundërshtuar me ngulm nga opozita<sup>2</sup>.

<sup>2</sup> Shih: “Liria e zgjedhjeve dhe obstruksionizmi i opozitës”, Shkodër, 1923

Metodat obstruksioniste janë njohur për opozitën parlamentare dhe, gjithmonë ka qenë i dyshimtë legjitimiteti i obstruksionit të shumicës parlamentare.

Në të vërtetë, edhe obstruksioni i shumicës parlamentare ka ekzistuar. Nuk është rast unikal, ai që ndodhi në Shqipëri, me obstruksionin e shumicës parlamentare, me qëllim që të pengohej shqyrtimi dhe miratimi i dekreteve të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrave. Rast të ngjashëm ndeshim edhe në Itali, por shumë më herët. Në mesin e viteve 60, shumica parlamentare e Dhomës së ulët të Parlamentit italian, nuk i dha leje zbatimit të pikave kryesore të programit të Qeverisë, të cilës ajo pak më parë i kishte dhënë votëbesimin<sup>3</sup>. Qysh atëhere, në Itali janë ngritur vazhdimisht zëra kundër legjitimitetit të obstruksionizmit të shumicës parlamentare.

Mjetet e përdorura kanë qenë të ngjashme si në obstruksionin e opozitës, ashtu edhe në obstruksionin e pozitës: strategjia e zgjatjes së afateve, diskutime të gjata pambarimisht, propozime dhe amendamente të vazhdueshme me qëllim zgjatjen e procesit të miratimit të ligjit, propozime për zgjerimin e rendit të ditës, etj. Obstruksioni i shumicës parlamentare ka qenë më i rrallë, por ka patur rezultatet e dëshiruara. Këtu, duhet të bëjmë mirë dallimin midis atij që quhet *obstruksion teknik* për të cilin folëm, nga *obstruksion fizik*, i cili manifestohet nëpërmjet dhunës dhe është krejtësisht i paligjshëm<sup>4</sup>.

Natyrisht, obstruksionizmi, ka qenë një metodë që ka sjellë pengesa në zbatimin e ligjeve e në punët parlamentare, prandaj në mjaft vende janë marrë masa kundërobstruksionizëm, me qëllim që ta minimizojnë atë e ta bëjnë të pafuqishëm. Le të përmendim këtu, strategjinë kundërobstruksioniste të reformave parlamentare të viteve 1981, 1983, 1986 në Itali. Këto reforma u përshkuan nga një strategji e përpunuar mirë antiobstruksioniste dhe u parashikuan mjaft dispozita në rregulloren e brendshme të të dyja dhomave

<sup>3</sup> Shih: Temistocle Martinez “Diritto Costituzionale”, Milano, 1997, fq. 344

<sup>4</sup> Po aty, fq.342



të Parlamentit italian, të cilat zvogëlonin rezultatin e metodave obstruksioniste në atë masë, sa që praktikisht, i thanë obstruksionizmit, Lamtumirë<sup>5</sup>!

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e jep ndihmesën e tij, pasi ka kaluar një kohë e gjatë që punët parlamentare vuajnë nga “sëmundja e obstruksionizmit”, kryesisht të opozitës. Dispozitivi i vendimit në fjalë, “*Nëse dekreti i Presidentit të Republikës, i nxjerrë në përputhje me nenin 98 të Kushtetutës, nuk shqyrtohet nga Kuvendi brenda afatit 10-ditor, ai nuk konsiderohet i miratuar apo i shfuqizuar*”, është në thelb, një masë kundërobstruksioniste. Ajo ngarkon me përgjegjësi për përmbushjen e detyrimeve kushtetuese, veçanërisht shumicën parlamentare, meqënëse posedon një forcë të konsiderueshme dhe dihet që, pasojat e obstruksionit të saj janë shumë më produktive sesa ato të opozitës parlamentare.

Më e rreptë në këtë aspekt paraqitet fryma antiobstruksioniste në mendimin e pakicës. “*Ometimi i Kuvendit për shqyrtimin e dekretit për emërimin dhe shkarkimin e ministrit, nuk duhet kuptuar thjesht si një kalim afati, sepse në thelb ai mbart një mesazh politik, të cilit i përafrohet një dorëheqje e heshtur e Kuvendit nga kompetencat e tij*”. Në këtë rast, vendimi do të kishte edhe një frymë “ndëshkimi” ndaj obstruksionistëve.

Mesazhi i vendimit është i qartë dhe mbi këtë bazë, Kuvendi mund të reagojë duke shfrytëzuar funksionin e tij vetërregullues. Në aktet e tij të brendshme, Ai mund të parashikojë edhe masa të tjera që do të dobësonin obstruksionizmin, pasi tani ajo është një metodë jotrasparente dhe e tejkaluar.

**Së dyti**, nga leximi i vendimit konkludojmë se, **dispozitat që parashikojnë emërimin dhe shkarkimin e ministrave janë të qarta dhe nuk është fjala për një boshllëk kushtetues**. Është kjo arsyeja dhe thelbi i faktit, që dispozitivi i vendimit duket në pamje të parë evaziv dhe pothuajse i ndryshëm nga vendimet e tjera të Gjykatës Kushtetuese, për

<sup>5</sup> Shih: Carmela De Caro Bonella “Ostruzionismo, Addio”, në “Quaderni Costituzionali”/ a.XI, n.2, gusht 1991

shkak të natyrës së papërcaktuar mirë. (“*Dekreti i Presidentit të Republikës...nuk konsiderohet i miratuar apo i shfuqizuar*”).

Kushtetuta ka parashikuar qartë dhe prerë mënyrën e emërimit dhe të shkarkimit të ministrave (shih nenin 98). Këtu ka mbaruar detyra e saj dhe ka filluar detyra e organeve kushtetuese, konkretisht e Kryeministrit, e Presidentit të Republikës dhe e Kuvendit të Shqipërisë, për ta zbatuar atë.

Duke bërë një interpretim të nenit 98 të Kushtetutës, nga pikëpamja doktrinale konkludojmë se, Kushtetuta shqiptare ka ndjekur një rrugë paksa më të ndryshme, nga ajo e ndjekur prej mjaft kushtetutave të tjera, të cilat e konsiderojnë emërimin e ministrave si një akt thelbësisht qeveritar dhe formalisht presidencial. Në rastin tonë, emërimi i ministrave paraqitet si akt më kompleks. Përmbajtja e tij shfaqet si thelbësisht qeveritare e formalisht presidenciale, parë që Presidenti i Republikës ka detyrimin kushtetues të dekretojë emërimin e ministrit të propozuar nga Kryeministri, brenda 7 ditëve. Megjithatë, në bazë të paragrafit të dytë të nenit 98 duket se ky vullnet nuk mjafton, pasi dekreti presidencial shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi. Pra, fakti që nuk mjafton vetëm vullneti i Kryeministrit dhe formaliteti sollemn i Presidentit të Republikës, e bën aktin e emërimit të ministrit, një akt kompleks. Ky interpretim doktrinor në njëfarë mase, pasqyrohet edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese kur theksohet: “*Shqyrtimi i Dekretit të Presidentit të Republikës..., nuk kufizohet vetëm në kontrollin formal të tij, por edhe në atë substancial, sepse ai është akt i një kontrolli politik të ngjashëm me atë që ushtrohet në kuadrin e një mocioni besimi apo mosbesimi*”. Por, në doktrinën kushtetuese është shprehur së fundmi edhe një mendim i ndryshëm me sa thamë më sipër<sup>6</sup>. Sipas konstitucionalistit Krenar Loloçi, “...fjala shqyrtim në këtë rast nuk mund të nënkuptojë kurrsesi fjalën miratim. ...mund të pranohet se dekretet e Presidentit nuk kanë nevojë

<sup>6</sup> Shih: Krenar Loloçi, “Kushtetuta e re dhe nevoja për një mentalitet të ri”, Tiranë, 2002, 30-35

për një miratim të mëpasëm nga ana e Kuvendit”<sup>7</sup>. Unë bashkohem me frymën e re që mundohet të evokojë autori Krenar Loloçi, i cili përpiqet të bëjë një ndarje më të rreptë të pushteteve. Kjo përshtatet edhe me frymën e përgjithshme të Kushtetutës. Por, duhet të pranoj se Kushtetuta nuk është e shkruar kështu. Nëse do të pranohet sa më sipër, atëhere përse do të shërbente paragrafi 2 i nenit 98 të Kushtetutës? Çfarë do të kuptojmë me termin *shqyrtim*, nëse nuk do të lejohej Kuvendi të shprehej mbi këtë fakt? Nëse do t’ i referohemi fjalorit të Gjuhës së sotme shqipe kur bëjmë interpretimin gjuhësor të fjalës “shqyrtohen”, atëhere do të arrijmë në konkluzionin se dekretet e Presidentit duhet të kqyren me hollësi e nga të gjitha anët për të formuar një mendim të përpiktë, për të bërë një vlerësim të drejtë a për të marrë një vendim<sup>8</sup>. Edhe në konceptin juridiko-kushtetues fjala shqyrtim nënkupton një proces të tërë që shoqërohet me marrjen e një vendimi. Nëse ky shqyrtim do të shërbente vetëm që Kuvendi të “...mund të “hakmerrej” kundër vetë Kryeministrit me një mocion mosbesimi”, atëhere nuk ishte e nevojshme të kishim një proces shqyrtimi nga ana e Parlamentit, por thjesht një komunikim të dekretëve apo një vënie në dijeni të Kuvendit. Megjithatë, është vetë Parlamenti që e interpreton këtë rast.

Në përfundim, marrim shkas të themi se, situata pezull, e krijuar nga mosshqyrtimi i dekretëve të Presidentit të Republikës nga Kuvendi, nuk ishte pasojë e boshllëqeve, të metave apo mosqartësisë së Kushtetutës, sikurse mund të jetë menduar. Ishte fjala thjesht për një vakuum institucional që u krijua nga mosveprimi politik i Kuvendit e jo nga vakuumi juridik.

**Së treti, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që bën interpretimin e neneve të Kushtetutës duhet t’ i qëndrojë besnik përmbajtjes së saj.** “...Kushtetuta nuk parashikon raste të tjera për shpërndarjen e Kuvendit nga Presidenti. Për rrjedhojë, fakti që Kuvendi nuk shqyrton

<sup>7</sup> Po aty

<sup>8</sup> “Fjalor gjuhës së sotme shqipe”, zëri *shqyrtoj*

*Dekretin e Presidentit të nxjerrë konformë nenit 98 pika 2 të Kushtetutës, nuk mund të shërbejë si shkak që ai të shpërndajë Kuvendin*” (nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese). Arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese është plotësisht i drejtë, pasi ka respektuar rreptësisht përmbajtjen e Kushtetutës. Kur Gjykata Kushtetuese interpreton Kushtetutën, ajo nuk procedon në të njëjtën mënyrë sikurse vepron me ligjet, në rastet kur kontrollon pajtueshmërinë e këtyre të fundit me Kushtetutën. Nëse konstatohet që ligji ose akti, apo një pjesë e tij, vjen në kundërshtim me Kushtetutën, atëhere është e drejtë-detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vendosë përjashtimin e tij ose, të pjesëve të veçanta të tij, nga rendi juridik. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për Kushtetutën. Gjykata nuk mund të heqë as një presje nga ajo çfarë thuhet në Kushtetutë. Ajo interpreton nenet e saj për rastin konkret që parashtrohet. Ky është kuptimi kushtetushmërisë së sotme dhe i hierarkisë ligjore në të cilën Kushtetuta përbën “*la tete de chapitre*”, pa zbatimin e të cilëve nuk ka shtet ligjor. Megjithatë, nuk do ta konsideronim një interpretim besnik vendimin në fjalë kur shprehet: “*Kuvendi duhet ta shqyrtojë dekretin pas këtij afati*”, pasi mund të konsiderohet si një zgjatje afati që nuk gjen legjitimim në Kushtetutë. Në këtë aspekt, më rigoroz paraqitet mendimi i pakicës.

*Së katërti*, të gjitha organet shtetërore kanë detyrë të zbatojnë Kushtetutën e ligjet dhe t’iu nënshtrohen atyre.

Ky është mesazhi i parë që del qartë në pah, nisur nga fryma e përgjithshme e vendimit. Duke iu referuar këtij vendimi, “*...duhet të kufizohet në interpretimin përfundimtar të dispozitave të lartpërmendura vetëm përse kërkohet në kërkesë dhe në seancë...*” lind pyetja: çfarë do të kuptojmë me interpretimin përfundimtar të dispozitave të Kushtetutës? Unë mendoj, se kjo do të thotë që, Gjykata Kushtetuese ndërhyr me kërkesën e palëve për të bërë interpretimin përfundimtar, pasi organet kompetente kanë bërë interpretimin e tyre gjatë zbatimit të Kushtetutës. Zbatimi me përpikmëri dhe rigorozitet i Kushtetutës dhe i akteve të tjera normative, përbën në radhë të parë, një detyrë për të gjitha subjektet.

Duke kryer veprimtarinë dhe aktivitetin e tyre, organet publike përvetësojnë mirë kuptimin dhe përmbajtjen e normave, i zbatojnë ato edhe duke i interpretuar<sup>9</sup>. Asnjë organ, përfshirë edhe organet më të larta kushtetuese, siç është Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës, Qeveria, organet vendore apo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve etj., nuk mund të shkarkohen nga përgjegjësia për moszbatimin e Kushtetutës dhe të akteve të tjera, me justifikimin se nuk e kuptojnë atë, ose se këto akte nuk shprehen drejtpërdrejt për problemin dhe rastin që zbatohet. Tashmë është i njohur fakti se, Parlamenti kur harton e miraton një ligj, mban parasysh që përmbajtja e tij të mos vijë në kundërshtim me Kushtetutën. Presidenti, mund të ushtrojë edhe *veto* në rastin kur konstaton ose mendon se, ndonjë artikull i ligjit të miratuar nga Parlamenti, vjen në kundërshtim me Kushtetutën etj. Kushtetuta dhe aktet e tjera normative janë të kuptueshme për të gjithë (së paku duhet të jetë kështu), gjë që përbën kusht kryesor për respektimin e tyre, jo vetëm nga institucionet publike, por edhe nga institucionet private si dhe, nga vetë shtetasit. Kushtetuta është “burimi i burimeve të së drejtës” dhe që nga momenti i hyrjes në fuqi, për të gjithë lind detyrimi që të përkulen me respekt përpara saj dhe ta zbatojnë me përpikmëri. Jo pa qëllim përdoret edhe termi “t” i nënshtrohen asaj”. Nënshtrimi ndaj ligjeve e sidomos ndaj Kushtetutës nuk ka asgjë të përbashkët me nënshtrimin ndaj pushtetit, përkundrazi është shumë fisnik, është kulturë, është respekt për shtetin dhe për njeriun, është paqe, është përparim. Ky është edhe thelbi i parimit të Shtetit të së Drejtës. Natyrisht, mund të ndodhë që Kushtetuta të ketë momente të paplota e të paqartësuara mirë që lindin gjatë zbatimit të saj, të cilat duhet të interpretohen apo në ndonjë rast të amendohen, por nuk mund të konsiderohen të tilla ato që krijohen si rezultat i moszbatimit të dispozitave

---

<sup>9</sup> Për interpretimin e ligjit shih: Luan Omari “Parime dhe institucione të së drejtës Publike”, Tiranë, 1998, fq. 198-204

të Kushtetutës. I referohemi rastit në fjalë: a është bërë zbatimi i Kushtetutës nga të gjitha organet kompetente të pushtetit shtetëror që marrin pjesë në emërimin e ministrave? Unë mendoj se jo. Kuvendi nuk është mbledhur për të shqyrtuar dekretet e Presidentit për emërimin e ministrave. Kjo e drejtë-detyrë e Kuvendit kishte një afat 10 ditor.

***Së pesti***, duke lexuar këtë vendim, edhe njëherë reflektoj në lidhje me një fakt që, gjithashtu, është bërë i diskutueshëm. Shtrohet pyetja: **subjektet që venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, a duhet t'i drejtohen asaj për të bërë interpretimin e Kushtetutës drejtpërdrejt, pa e kërkuar këtë në kuadrin e kërkesës për pajtueshmërinë e akteve me Kushtetutën apo për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve institucionale?** Neni 124 i Kushtetutës i cili thekson se, “Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj”, shpreh funksionin dhe misionin e Gjykatës Kushtetuese. Kushtetuta është e qartë dhe nuk lë ekuivok kur parashikon kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Kompetencat e saj parashikohen në nenin 131 të Kushtetutës, por edhe në disa artikuj të tjerë (disa kompetenca të lidhura me organet e tjera dhe personat zyrtarë). Në këtë aspekt, do të mendoja se, Gjykata bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, përmes ushtrimit të kompetencave të saj e përmes vendimeve që jep për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të mospajtueshmërive që shqyrton. Gjykata Kushtetuese nuk mund të pranojë kërkesa për të bërë interpretimin e Kushtetutës, sa herë që subjektet, të cilat kanë të drejtë ta vënë atë në lëvizje, i drejtohen për të “sqaruar” këtë pjesë apo atë nen të Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese mund të pranojë kërkesat, pasi të gjitha organet që marrin pjesë në një veprimtari, të kenë dhënë zgjidhjen e tyre duke bërë ato vetë paraprakisht, interpretimin e Kushtetutës. Në këtë aspekt, interpretimi i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të kërkohej si “mburojë” e si “urë shpëtimi” për veprimet politike e për të shkarkuar nga përgjegjësia organet shtetërore. Kjo do të sillte një mbingarkesë të

paarsyeshme të Gjykatës Kushtetuese dhe pamundësi në ushtrimin e punëve të saj. Këtu është rasti për të nënvizuar faktin se, kur lindin probleme e nevoja të tilla, më mirë mund të shfrytëzohen edhe organe të tjera kompetente e sidomos, katedrat universitare, specialistët e fushës, akademistët, të cilët duket se janë harruar krejt. Nga ana tjetër, është detyrë edhe e këtyre të fundit, që ta thonë më mirë fjalën e tyre dhe të shkruajnë në lidhje me problemet e shtruara.

# Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

*Filip Lako*

**Ligj nr.8763, datë 2.4.2001 “Për një shtesë në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”** Me këtë ligj bëhet një plotësim i legjislacionit në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Deri sot, subjektet e ndryshme vendase ose të huaja, kanë kryer veprimtari në akuakulturë, duke qenë të pajisur vetëm me licencën për ushtrimin e kësaj veprimtarie, pa paguar qira për shfrytëzimin e sipërfaqes ujore. Me ligjin e lartpërmendur, këto subjekte do të paguajnë edhe qira, vlera e së cilës do të caktohet me vendime të Këshillit të Ministrave. Duke qenë qiraja me afate kohore, subjektet do të bëhen të interesuara për të bërë investime e për të mos kultivuar vetëm midhje, si deri sot, por duke ushtruar edhe veprimtari të tjera. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.5.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.19 të vitit 2001, faqe 567.

**Ligj nr.8764, datë 2.4.2001 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.1, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm të një anijeje ushtarake franceze në Portin e Durrësit”.** Në pikën 3 të nenit 12 të Kushtetutës përcaktohet se asnjë forcë e huaj ushtarake nuk mund të vendoset dhe as të kalojë në territorin shqiptar, përveçse me një ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nisur nga kjo, bazuar në nenin 101 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave nxorri aktin normativ nr.7, datë 26.2.2001, akt me të cilin i jepet leje për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm nga data 2 deri 5 mars 2001, në Portin e Durrësit, të anijes ushtarake franceze “Commandant BIROT”. Bazuar



po në nenin 101 të Kushtetutës, këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve, prandaj me ligjin nr.8764, datë 2.4.2001 Kuvendi ka miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave. Ligji ka 1 nen, dhe i bashkëlidhet edhe akti normativ. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.19 të vitit 2001, faqe 568.

**Ligj nr.8765, datë 2.4.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8113, datë 28.3.1996 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”.** Shtesat dhe ndryshimet në ligjin ekzistues e plotësojnë më mirë atë. Kështu, me këtë ligj mund të dekorohen, krahas shtetasve shqiptarë ose të huaj, edhe personat juridikë. Emërtimi i Urdhrit “Mjeshtër i Madh i Punës”, ndryshohet në “Mjeshtër i Madh” në mënyrë që të ketë hapësirë më të gjerë për dhënien e këtij Urdhri. E vetmja shtesë bëhet pas nenit 14 të ligjit në fuqi, duke shtuar nenin 14/1 me këtë përmbajtje: “Medalja “Për merita të veçanta civile” u jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për merita të veçanta civile në Shqipëri. Kjo medalje do të jetë e artë”. Ligji ka 6 nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.5.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.19 të vitit 2001, faqe 569.

**Ligj nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”.** Ky ligj rregullon veprimtarinë e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit (PMZSH), e cila si pjesë e administratës, në përbërje të strukturës së Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe e strukturave të prefektit, ka për detyrë të mbrojë jetën e njerëzve dhe pronën nga rreziku i zjarrit dhe i fatkeqësive natyrore. Ligji përcakton strukturën e kësaj policie, kriteret për fitimin e gradave, pranimin në këtë polici në nivel bazë dhe në nivelin e mesëm dhe të lartë, trajtimin e tyre, emërimin e lirimin nga detyra, statusin, si dhe uniformat, stema dhe gradat. Gjithashtu, rregullim gjejnë edhe problemet e buxhetit dhe marrëdhëniet me administratën publike, detyrat e organeve qendrore dhe vendor, masat për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në

projektimin dhe ndërtimin e veprave, detyrat dhe të drejtat e PMNZSH-së, trajtimi i punonjësve të tyre, shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative etj. Ligji ka 43 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.5.2001. Me miratimin e këtij ligji është shfuqizuar ligji nr.7707, datë 17.5.1993 “Për mbrojtjen nga zjarri”. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.19 të vitit 2001, faqe 570.

**Ligj nr.8767, datë 5.4.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjet nr.8039, datë 23.11.1995, nr.8074, datë 22.2.1996, nr.8112, datë 23.3.1996.** Me këtë ligj bëhen 17 ndryshime dhe 8 shtesa në ligjin ekzistues “Për prokurimin publik”, me qëllim përmirësimin e tij dhe plotësimin me dispozita të diktura nga përvoja e fituar dhe nevoja e punës. Kështu, ky ligj, me ndryshimet që i bënenit 1, përcakton rregullat për prokurimet e mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve. Gjithashtu, në nenet e tjera përcakton qartë nocionet “Fonde publike”, “Pezullim”, “Rivlerësim” dhe “Anullim” (i procedurës së prokurimit). Në ndryshim nga ligji në fuqi, që vetëm ndalonte stimujt që jepnin kandidatët për t’u bërë favore, ky ligj i titullon ato “veprime komptive dhe i vlerëson ato si shkelje administrative dhe vepra penale. Për rastet e veçanta, emergjente ose të forcave madhore, parashikohet që Këshilli i Ministrave mund të lejojë përdorimin e një procedure prokurimi, përveç tenderit të hapur. Shtesa e ndryshime të shumta bëhen në nenin që flet për kushtet për përdorimin e “prokurimit të drejtpërdrejtë” dhe në nenin për kundërvajtjet administrative. Ligji ka 21 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.5.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.19 të vitit 2001, faqe 582.

**Ligj nr.8768, datë 19.4.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Dioqezës në Rrëshen dhe Karitasit Shqiptar për ngritjen dhe funksionimin e shkollës së mesme profesionale “Shën Jozef**

**Punëtor**". Me ligjin e lartpërmendur ratifikohet kjo Marrëveshje, e cila ka për qëllim që të ofrojë ndihmë shkollimi në Dioqezën e Rrëshenit, e cila përfshin rrethet Mirditë, Mat, Bulqizë e Dibër, rrethe në të cilat nuk ekzistojnë shkolla profesionale. Qëllimet e veprimtarisë që përcaktohen në këtë Marrëveshje janë humanitare dhe jofitimprurëse, kurse bashkëpunimi do të jetë në fushën e edukimit profesional për ngritjen dhe funksionimin e një shkollre profesionale dhe të konviktit, ku do të mësojnë të rinjtë nga moshë 14-18 vjeç. Marrëveshja është nënshkruar më 14.2.2001. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 2.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 669. Bashkëlidhet Marrëveshja.

**Ligj nr.8769, datë 19.4.2001 "Për ratifikimin e "Konventës Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, Itali, për shumën 12.713.114.625 lira italiane për financimin e rehabilitimit të rrugës Tapizë – Fushë-Krujë, si dhe për urat e Matit dhe të Drinit, në kuadër të Programit "Rrugët Kombëtare".** Me këtë ligj ratifikohet Konventa financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale, Itali, për të financuar rehabilitimin e rrugës Tapizë - Fushë-Krujë, si dhe për urat e Matit dhe të Drinit, në kuadër të programit "Rrugët Kombëtare". Konventa përmban afatin e mënyrën e përdorimit të kredisë, kërkesat për akreditim fondesh, kthimin e kredisë dhe pagimin e interesave, lëshimin e deklaratës së njohjes së borxhit, detyrimet e huamarrësit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 672. Bashkëlidhet Konventa.

**Ligj nr.8770, datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike".** Me miratimin e këtij ligji realizohet delegimi i disa detyrave nga Policia e Shtetit te Shoqëritë e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike, duke bërë

të mundur që Policia e Shtetit të sigurojë vetëm objektet më të rëndësishme, të parashikuara në vendime të Këshillit të Ministrave. Ligji përcakton se licencën për drejtuesin teknik të shoqërisë (i cili duhet të jetë me arsimin e lartë policor) e jep Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, kurse licencën për punonjës in e shërbimit e jep drejtori i policisë së qarkut. E veçantë dhe e specifikuar do të jetë, sipas këtij ligji, licenca për shoqërimin e vlerave monetare dhe të sendeve të çmuara, e cila jepet vetëm për këtë veprimtari dhe me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës. Drejtuesi teknik i kësaj shoqërie duhet të ketë përvojë pune në shërbimet e policisë jo më pak se 10 vjet. Gjithashtu, ky ligj parashikon edhe dhënien e licencës për ushtrim të veprimtarisë për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave juridikë dhe fizikë, vendas e të huaj. Rregullim gjejnë në këtë ligj edhe probleme që lidhen me uniformën, armatimin, trajtimin etj. Ligji ka 24 nene, ka hyrë në fuqi më 3.6.2001 dhe me miratimin e tij janë shfuqizuar: ligji nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, ligji nr.7696, datë 7.4.1993 “Për shërbimin e rojeve civile” dhe ligji nr.7985, datë 13.9.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7696, datë 7.4.1993 “Për shërbimin e rojeve Civile”. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 684.

**Ligj nr.8771, datë 19.4.2001 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”.** Me këtë ligj sanksionohet fakti se kufiri shtetëror i Republikës së Shqipërisë përcaktohet në aktet ndërkombëtare dhe në aktet e tjera ndërkombëtare dypalëshe të përfunduara mes shtetit shqiptar dhe shteteve fqinje. Ai nuk mund të ndryshojë përveçse në bazë të marrëveshjeve, akteve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare të njohura dhe të nënshkruara nga shteti shqiptar. Gjithashtu, ligji përcakton se si tregohet kufiri shtetëror, kur shtrihen ujërat territoriale, cilët janë ujërat e brendshme, regjimin i lundrimit dhe fluturimit etj. Me miratimin e këtij ligji, i cili ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.6.2001, shfuqizohet dekreti nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë,

ndryshuar me dekretet nr.5384, datë 23.2.1976 dhe nr.6181, datë 26.4.1980. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 689.

**Ligj nr.8772, datë 19.4.2001 “Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”.** Ky ligj përcakton rregullat e ruajtjes dhe të kontrollit të kufirit shtetëror, rregullat për kalimin e shtetasve shqiptarë ose të huaj dhe të mjeteve nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe strukturën shtetërore dhe statusin e saj, me qëllim garantimin e zbatimit të këtyre rregullave. Gjithashtu, ligji përmban edhe strukturën, veprimtarinë dhe detyrat e Policisë Kufitare, mënyrën sesi bëhet ruajtja dhe kontrolli i kufirit shtetëror, kontrolli në kufi, mënyrën se si bëhet kalimi i kufirit dhe klasifikim i vendkalimeve kufitare, kontrolli i mjeteve lundruese etj. Në kreun e sanksioneve, përveç përcaktimit se cilat shkelje përbëjnë kundërvajtje administrative dhe caktimit të masës së gjobës, i jepet zgjidhje edhe faktit se si do të bëhet kthimi i të huajve që nuk lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë. Ligji ka 39 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.6.2001. Me hyrjen në fuqi të tij, shfuqizohet dekreti nr.5222, datë 21.11.1974 “Për rregullat e zbritjes dhe të qëndrimit në tokë të personave, të ekuipazhit të anijeve të huaja në kohën që ndodhen në portet e Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.8342, datë 6.5.1998 “Për Policinë Kufitare”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 691.

**Ligj nr.8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”.** Me këtë ligj vendosen rregulla të qarta për tubimet. Ai përcakton se për organizimin dhe zhvillimin e një tubimi, pavarësisht se cilët janë organizatorët ose nxitësit e tij, duhet të caktohet një drejtues për zhvillimin normal të tubimit. Ligji parashikon detyrimin për të njoftuar me shkrim policinë, të drejtat dhe detyrat e drejtuesit e tubimit, praninë e medias gjatë zhvillimit të tubimeve, ndalimin e zhvillimit të tubimeve etj. Në krahasim me ligjin e shfuqizuar, ky ligj rregullon më mirë,

më qartë e më saktë organizimin e tubimeve në vende të hapura për publikun, ndalimin dhe mbylljen e tubimit, rastet se kur ndërhyjnë policia e shtetit dhe të drejtat e saj për të regjistruar zërat, për të fotografuar dhe për të filmuar, vetëm në rast se ka arsye për të besuar se ekziston një rrezik i menjëhershëm për rendin dhe sigurinë publike. Ligji ka 27 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.6.2001. Ky i ligj ka shfuqizuar ligjin nr.8145, datë 11.9.1996 “Për të drejtën e tubimeve”. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 701.

**Ligj nr.8774, datë 23.4.2001 “Për ratifikimin e “Konventës nr.182 “Format më të këqia të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.** Në këtë Konventë parashikohet që çdo anëtar, që e ratifikon atë, duhet të marrë masa të menjëhershme dhe efektive, për të siguruar ndalimin dhe shmangien e formave më të këqia të punës së fëmijëve, si një çështje urgjente. Në kuptim të kësaj Konvente, termi “fëmijë” nënkupton të gjithë personat nën moshën 18 vjeç. Rëndësi ka fakti që kjo Konventë parashikon detyrimin që ka çdo anëtar për të marrë të gjitha masat e nevojshme, për të siguruar zbatimin efektiv dhe hyrjen në fuqi të dispozitave, që i japin efekt kësaj Konvente, duke përfshirë dispozitat dhe zbatimin e sanksioneve penale ose të sanksioneve të tjera, ndaj të gjitha formave të skllavërisë së fëmijëve ose formave të ngjashme me të, si shitja, trafikimi i tyre, prostitucioni, pornografia etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 708. Bashkëlidhet konventa.

**Ligj nr.8775, datë 23.4.2001 “Për ratifikimin e “Konventës nr.131, datë 6.6.1970 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Caktimi i Pagës Minimale””.** Sipas Konventës së lartpërmendur, çdo anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës, i cili e ratifikon atë, angazhohet të krijojë një sistem të pagës minimale, i cili të mbrojë të gjitha grupet e rrogëmarrësve, kushtet e punësimit të të cilëve janë të tilla që kërkojnë

mbrojtje të përshtatshme. Gjithashtu, Konventa rregullon edhe probleme të tjera dhe vendos detyrime për ratifikuesit për të zbatuar procedurat që ajo ka parashikuar. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.23 të vitit 2001, faqe 712. Bashkëlidhet Konventa.

**Ligj nr.8776, datë 26.4.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.7932, datë 17.5.1995, nr.8286, datë 16.2.1998, nr.8392, datë 2.9.1998 dhe nr.8575, datë 3.2.2000.** Me shtesat e ndryshmet që bën ky ligj plotësohet e rregullohet më mirë ligji “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kështu në nenin 2 “Sigurimet e detyrueshme”, do të quhen “sigurimet shoqërore të detyrueshme”. Gjithashtu, me këtë ligj, sigurimin shoqëror suplementar, përveç ushtarakëve që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura, do ta përfitojnë edhe ata që shërbejnë në policinë e shtetit dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH). Ky ligj bën një ndarje më të saktë e më të detajuar të sanksioneve, duke i ndarë në kamatëvonesa (në 3 raste) dhe gjoba (në 6 raste). Gjithashtu, saktësohet më qartë se kur jepet shtesë pensioni dhe sa është masa e shtesës dhe më tej përcakton në mënyrë të plotë detyrimet e punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit. Në gjithë përmbajtjen e ligjit në fuqi, aty ku përdoret termi “të ardhura”, do të zëvendësohet me termin “përfitime” dhe termi “kontribucione” do të zëvendësohet me termin “kontribute”. Ligji ka 20 nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.24 të vitit 2001, faqe 733.

**Ligj nr.8777, datë 26.4.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin teknik, financiar dhe asistencën humanitare”.** Sipas kësaj Marrëveshjeje të dy qeveritë, brenda

kuadrit të legjislacionit të vendeve që iu përkasin, do të promovojnë realizimin e projekteve të asistencës teknike dhe financiare në Shqipëri. Këto projekte do të mbështesin reformat politike, ekonomike dhe sociale në Shqipëri dhe do të lehtësojnë kostot ekonomike dhe sociale të procesit të transformimit. Marrëveshja parashikon format e bashkëpunimit, asistencën teknike dhe financiare, klauzolat antikorrupsion, kohëzgjatjen etj. Ligji që ratifikon këtë Marrëveshje ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.24 të vitit 2001, faqe 737. Bashkëlidhet Marrëveshja.



## Information on laws passed by Assembly

*Filip Lako*

**Law no. 8763 dated 02.04.2001 “ For a supplement to law no. 7908 dated 05.04.1995 “ On fishing and aquaculture”.**This law completes the legislation in the fishing and aquaculture sector. To date, various home and foreign entities have operated in aquaculture, being equipped only with the license for the exercise of this activity, without paying rent for the exploitation of the water area. Under the above-mentioned law these entities will pay rent, the value of which shall be estimated in the decisions of the Council of Ministers. With the rent being given within time limits, the entities, which so far have been cultivating only mussels, will be more interested in investing and practising other activities. The law has 2 articles and entered into force on 19.05.2001. It is published in the Official Gazette no.19, 2001, pg.567.

**Law no.8764 dated 02.04.2001 “ On the approval of the normative act with the power of law, no.1 dated 26.02.2001 of the Council of Ministers “ On the permission for the entrance and temporary stay of a French warship into the port of Durres.”** Point 3 of article 12 of the Constitution lays down that no foreign military force can neither be located nor pass in the Albanian territory, except under a law passed with the majority of the Members of Parliament. Based on article 101 of the Constitution, the Council on Ministers issued a normative act no.7 dated 26.02.2001, by means of which the French warship “Commandant BIROT” is given permission to enter and stay temporarily from 2 March up to 5

March 2001, into the port of Durrës. Based on article 101 of the Constitution, these acts lose power from the very beginning, if the Parliament does not approve them within 45 days, hence under law 8756 dated 02.04.2001 the Parliament passed the normative act with the power of law no.1 dated 26.02.2001 of the Council of Ministers. The law has 1 article and the normative act is attached to it. It is published in the Official Gazette no.19, 2001, pg.568.

**Law no. 8765, dated 02.04.2001 “ On some supplements and amendments to law no.8113 dated 28.03.1996 “ On the medals in the Republic of Albania”** The supplements and amendments to the existing law make it more complete. So, under this law, the legal persons, in addition to Albanian and foreign citizens, can be decorated. The denomination of the Order “ Great Master of Work”, is amended to “Great Master” so that wider space is provided for the bestowal of this Order. The only supplement is made after article 14 of the standing law, adding article 14/1 with the following content: “ The medal “For special civil merits” is bestowed to Albanian and foreign citizens for special civil merits in Albania. This medal must be golden”. The law has 6 articles and entered into force on 29.05.2001. It is published in the Official Gazette no.19, 2001, pg.569.

**Law no.8766 dated 05.04.2001 “ On the fire protection and rescue”.** This law regulates the activity of Police for the Protection against Fire and the Rescue (PPFR), which as part of the administration, in the composition of the structure of the Ministry of Local Government and the structure of the Prefecture, must protect the people’s lives and the property from the danger of fire and natural disasters. The law stipulates the structure of this police, the criteria for the winning of the ranks, the acceptance to the police at the base, middle and high level, their treatment, nomination and discharge from the duty, the statute, the uniforms and the ranks. Moreover,

the problems of the budget, the relations with the public administration, the tasks of the central and local government, the measures for the protection against fire and the rescue in the projection and the building of the works, the duties and the rights of the (PPFR), the treatment of their workers and the consideration of the administrative contravention are regulated under this law. The law has 43 articles and entered into force on 19.05.2001. With the approval of this law, law no.7707 dated 17.05.1993 “ On the fire protection” is repealed. It is published in the Official Gazette no.19, 2001, pg.570.

**Law no. 8767 dated 05.04.2001 “ On some supplements and amendments to law no. 7971 dated 26.07.1995 “ On public procurement” amended in law no. 8039 dated 23.11.1995, no. 8074 dated 22.02.1996, and no. 8112 dated 23.03.1996.** Under this law 18 amendments and 8 supplements are made to the existing law “On public procurement”, aiming at its improvement and completion with provisions laid down from gained experience and the necessity of work. Hence, this law with the amendments made to article 1 envisions the rules for the procurement of goods, construction work and services. The other articles clearly define the notions “ Public Funds”, “Suspension” “Revaluation” and “ Cancellation” (of the procurement procedure). Differently from the standing law, that forbid the stimuli offered by the candidates to be favoured, this law names them as “corruptive actions and qualifies them as administrative contravention and criminal offence”. For special cases, emergent or from the major forces, it is stipulated that the Council of Ministers can allow the use of procurement procedure, with the exception of the open bid. Numerous supplements and amendments are made to the article on the terms for the “direct procurement” and to the article on the administrative contravention. The law has 21 articles and entered into force on 19.05.2001. It is published in the Official Gazette no.19, 2001, pg.582.

**Law no. 8768 dated 19.04.2001 “ On the ratification of the “ Agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania, Diocese in Rreshen and the Albanian Caritas for the building and the functioning of the Professional High School “ Shen Jozef Punetor”**

Under the above-mentioned law the Agreement which aims at offering educational help to the Diocese of Rreshen, including the districts of Mirdita, Mat, Bulqiza and Dibra, where no Professional High Schools exist, is ratified. The aims of this activity, laid down in this agreement, are humanitarian and non-profitting, whereas the cooperation will be in the professional and educational field for the building and the functioning of the Professional High School and the dormitory. Students from the age of 14 up to 17 will be studying in this school. The agreement was signed on 14.02.2001. The law has 2 Articles and entered into force on 02.06.2001. It is published in the Official Gazette no. 23, 2001, pg.669. The Agreement is attached to it.

**Law no.8769 dated 19.04.2001 “On the ratification of the “Financial Convention between the Government of the Republic of Albania and the Central Mediocredit, Italy, for the total 12.713.114.625 lira (Italian) concerning the funds for the rehabilitation of Tapiz-Fushekruje Road, as well as the bridges of Mat and Drini in the framework of the program “National Roads”**

Under this law the Financial Convention between the Government of the Republic of Albania and the Central Mediocredit, Italy, concerning the funds for the rehabilitation of Tapiz-Fushekruje Road, as well as the bridges of Mat and Drini in the framework of the program “National Roads” is ratified. The Convention contains the deadline and method of using the credit, the requests for funds accreditation, the restitution of the credit, the pay of the interests, the issue of the statement recognising the debt, the duties of the loan-taker, solution of the disagreements, etc. The law has 2 articles and entered into force on 03.06.2001. It is published in the Official Gazette no.23, 2001, pg.672. The Convention is attached to it.

**Law no.8770 dated 19.04.2001 “On the service for the physical protection and security”.** With the approval of this law the delegation of some duties from the State Police to the Associations of the physical protection and security is realised, so the State Police shall be responsible only for the most important objects, provided for in the decisions of the Council of Ministers. The law envisions that the Director General of Police issues the license for the technical manager of the association (who must be equipped with Police University Education), whereas the director of the District Police issues the license for the service servant. Pursuant to this law, the license for accompanying the monetary values and precious objects will be special and specified only for this activity and in the whole territory of the Republic of Albania. The technical director of this association should have not less than 10 years working experience in the Police Services. This law envisions also the issuing of the license in the exercise of the activity for the protection of life and health of the physical and legal persons, Albanian and Foreigners. Some other problems concerning the uniform, armament, and treatment are also regulated under this law. The law has 24 articles and entered into force on 03.06.2001 and with its approval the following laws are repealed: Law no7550 dated 20.01.1992 “On the police of objects”, law no. 7696 dated 07.04. 1993 “On the service of the civil guards” and law no. 7985 dated 13.09.1995 2 On some supplements and amendments to law no. 7696 dated 07.04.1993 “On the service of the civil guards” It is published in the Official Gazette no. 23, 2001,pg.684.

**Law no. 8771 dated 19.04.2001 “ On the State frontier of the Republic of Albania”.** Under this law the fact that the State frontier of the Republic of Albania is laid down in the international acts and other bilateral international acts between the Albanian State and the neighbour countries is sanctioned. It can not change unless on the basis of the agreements, inter-

national normative acts recognised and signed by the Albanian State. The law lays down also the way the state frontier is displayed, the extension of the territorial water, which are the interior waters, the sailing, flying regime etc. With the approval of this law which has 7 articles and entered into force on 03.06.2001, the decree no.4650 dated 09.03.1970 “ On the State frontier of the Socialist Republic of Albania” amended by decree no.5384 dated 23.02.1976 and no.6181 dated 26.04.1980. It is published in the Official Gazette no.23, 2001, pg.689.

**Law no. 8772 dated 19.04.2001 “ On the protection and control of the state frontier in the Republic of Albania”.** This law determines the rules for the protection and control of the state frontier, the rules for the passage of the Albanian citizens or foreigners and the vehicles in the territory of the Republic of Albania, as well as in the state structure and its statute, aiming at guaranteeing their application. The law envisions the structure, the activity and the duties of the Frontier Police, the way the protection and control of the state frontier is performed, the frontier’s control, the way the passage of the frontier is carried out and the classification of the frontier’s passage, the control of the sailing vessels etc. In the chapter on the sanctions, except the definition that which contravention are an administrative contravention and the estimation of the fine, a solution is given to the way the return of the foreigners, who are forbidden to enter the territory of the Republic of Albania, shall be performed. The law has 39 articles and entered into force on 03.06.2001. With the entering into force of this law decree no.5222 dated 21.11.1974 “ On the rules of landing and accommodation of the persons, crew of the foreign ships during their stay in the ports of the Republic of Albania”, law no. 8342 dated 06.05.1998 “On the frontier police” as well as every other provision that that falls into objection with this law are repealed. It is published in the Official Gazette no. 23,2001,pg.691.

**Law no. 8773 dated 23.04.2001 “On Rallies”.** This law provides clear rules for the rallies. It lays down that the organisation and the holding of the rallies, regardless of its organisers or instigators, a leader should be appointed for the normal holding of the rally. The law envisions the obligation to inform in a written form the police, the rights and the duties of the leaders of the rally, the presence of the media during the rally, the ban for the holding of the rally, etc. Compared to the abrogated law, this law regulates better, more clearly and precisely the organisation of the rallies in the open places for the public, the ban and the closing of a rally, the cases when the state police intervenes and their right to record the voices, to take photos and shoot, only in those cases when there are sound reasons to believe that there exists an immediate danger for the public order security. The law has 27 articles and entered into force on 03.06.2001. This law repealed law no.8145 dated 11.9.1996 “ on the rights to rallies”. It is published in the Official Gazette no.23, 2001, pg.701.

**Law no. 8774 dated 23.04.2001 “ On the ratification of the “Convention no.182 “The worst forms of children’s labour, 1999” of the International Organisation of work”.** This convention stipulates that every member that ratifies it should take immediate and effective measures to guarantee the prevention and the avoidance of the worst forms of children’s labour, as an emergent issue. The term “children” in this convention refers to every one below the age of 18. The fact that this convention envisions the obligation that every member has to take all the necessary measures to grant the effective application and the entering into force of the provisions that put this convention into effect, including the provisions and the application of the criminal and other sanctions against all the forms of the children’s slavery or similar forms, such as selling, trafficking, prostitution, pornography etc, marks an important step. The law has 2 articles and entered into force on 03.06.2001. It is published in the Official Gazette no. 23, 2001,pg.708. The Convention is attached to it.

**Law no.8775 dated 23.04.2001 “ On the ratification of the “Convention no.131 dated 06.06.1970 of the International Organisation of Work “ The fixing of a minimal pay”.** Pursuant to the above-mentioned Convention, every member of the International Organisation of Work, which ratifies it, is committed to create a system of the minimal pay, which shall protect all salaried, whose terms of employment require an appropriate protection. The Convention regulates other problems and sets duties for the ratifying countries to implement the procedures envisioned by it. The law has 2 articles and entered into force on 03.06.2001. It is published in the Official Gazette no.23, 2001.pg.712. The convention is attached to it.

**Law no.8776 dated 26.04.2001 2 On some supplements and amendments to law no. 7703 dated 11.05 1993 “On social insurance in the Republic of Albania”, amended by laws no.7932, dated 17.05.1995, no.8286 dated 16.02.1998, no. 8392 dated 02.09.1998 and no.8575 dated 03.02.2000.** With the supplements and amendments of this law, the law “On social insurance in the Republic of Albania” is better completed and regulated. Hence, in article 2 “obligatory insurance” will be called “obligatory social insurance”. Under this law the supplementary social insurance, with the exception of the military officers serving in the structures of the Armed Forces, will benefit even those serving in the State Police and the State Informative Service (SHISH). This law makes a more accurate and detailed division of the sanctions, dividing them in default interests (3 cases) and fines (6 cases). It determines clearly those cases when a pension increase is granted and the amount of this sum as well as the obligations of the employer and the self-employed. In the whole content of the law in effect the term “revenues” will be replaced with the term “benefits” and “contribucions” with “contributions”. The law has 20 articles and entered into force on 05.06.2001. It is published in the Official Gazette no. 24.2002.pg.733.



**Law no. 8777 dated 26.0.2001 “ On the ratification of the “Agreement between the Government of the Republic of Albania and the Government of the Swiss Confederation for technical and financial cooperation as well as humanitarian aid.”** Pursuant to this Agreement both governments, within the framework of the legislation of the relevant countries, will promote the realisation of projects of the technical and financial assistance in Albania. These projects will support the economic, political, and social reforms in Albania, as well as ease the economic and special costs of the transformation process. The Agreement stipulates the forms of cooperation, technical and financial assistance, anti-corruption provisions, timing etc. The law ratifying this Agreement has 2 articles and entered into force on 05.06.2001. It is published in the Official Gazette no.24, 2001, pg. 737. The Agreement is attached to it.



Personat që janë të interesuar të  
abonohen në këtë Revistë, janë të lutur  
të kontaktojnë në adresën:  
**Rruga “Vaso Pasha”, Pall.2, shk. 1.**  
**☎: 04 223501, e-mail:**  
berberiscdp@albaniaonline.net

---

Botuesit e kësaj Reviste mirëpresin dhe e  
vlerësojnë si ndihmë çdo vërejtje apo sugjerim  
për përmirësimin e cilësisë së Revistës. Vërejtjet  
dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni në adresën  
e sipërpërmendur.

*Ju faleminderit!*

---

*Those who are interested to register are  
pleased to contact at:*  
**Rruga “Vaso Pasha”, Pall.2, shk. 1.**  
**☎: 04 223501, e-mail:**  
berberiscdp@albaniaonline.net

---

The editors welcome any suggestion or comment  
to improve the quality of the Review. You can send  
your comments and suggestions to the above  
mentioned address.

*Thank You!*

---

Kopertina: R&T Advertising  
Art grafik: Elvira Çiraku

---

Shtypur në shtypshkronjën “ALB Paper”

---

**Drejtor i Revistës:** Sokol BERBERI

**Kryeredaktore:** Elira ZAKA

**Bordi editorial:** Filip LAKO  
Perikli ZAHARIA  
Leon SHESTANI  
Sokol BERBERI

**Përkthyes:** Engjëllushe SHQARRI

**Redaktor:** Pandeli KOÇI

**©Copyright 2001:** Qendra Studimore mbi Praktikat  
Parlamentare dhe Demokratike

---

**Kjo revistë botohet me mbështetjen financiare të  
International Republican Institute (IRI)  
dhe National Endowment for Democracy (NED)**













